



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

Nr 1486 Prot

Elbasan më 19 /03/2025

RELACION

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Shkurt 2025

KËSHILLIT BASHKIAK

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 23 datë 04.03.2025 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

**Propozojmë:**

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për muajin Shkurt 2025 gjithsej 81 familje me një fond gjithsej 230.000 lekë .  
Këto janë familje shumë të varfëra të cilat nuk kanë mundësi të aplikojnë në sistemin e ndihmës ekonomike pasi për shkaqe të ndryshme sociale, shëndetësore dhe ekonomike, një anëtar madhor nuk është prezent gjatë aplikimit .  
Këto janë raste të grave të braktisura nga bashkëshortët e tyre dhe anasjelltas, familje të cilat kanë në përbërje të tyre anëtarë madhorë me probleme të shëndetit mendor të cilët largohen nga banesa pa adresë fikse, familje që kanë në përbërje të tyre anëtarë madhorë me probleme të ndryshme sociale (alkooli, droga etj) të cilët nuk janë në gjendje të paraqiten në ditën e aplikimit të ndihmës ekonomike në sistem.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.

Konceptoi: M.Duka  
Pranoi: D.Shuli  
Konfirmoi: D.Rroseni

Zv/Kryetari

Armand Shehu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Elbasan më \_\_\_\_/03/ 2025

**PROJEKT - VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_/03/ 2025

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin SHKURT 2025**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_/03/2025 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga DSHKSK, bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 23 datë 04.03.2025 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

**VENDOSI**

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për muajin SHKURT 2025 për 81 familje me një fond prej 230.000 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr Shërbimeve Sociale  
Drejtori Juridik

D.Shuli  
A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet

A. Merkja

**Sekretar i Këshillit Bashkiak**  
Sokol Sinani

**Kryetari i Këshillit Bashkiak**  
Lutfi Lala



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

Nr.Prot 1485

Elbasan më 18 /03/2025

**RELACION**

**Mbi dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin Shkurt 2025  
KËSHILLIT BASHKIAK**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 24 datë 04.03.2025 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”, paraqesim për miratim propozimin e familjeve që do trajtohen nga fondi i kushtëzuar.

**I. Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin SHKURT 2025 ,  
261 familje me një fond prej 1.342.671 lekë.**

Këto janë familje të varfra të cilat kanë aplikuar në sistemin e ndihmës ekonomike dhe për shkak se nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme, nuk janë kualifikuar përfitues të ndihmës ekonomike nga sistemi i pikëzimit.

Këto janë kryesisht familje me një ose dy antarë. Pra këtu kemi familje të cilat janë me një anëtarë, si femrat ose meshkujt në moshë të madhe të pamartuar ose të divorcuar, të cilët kanë ose jo një ose dy fëmijë në ngarkim ; personat mbi moshë pune të cilët nuk kanë përfituar pension pleqërie .

Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.

Konceptoi: M.Duka  
Pranoi: D.Shuli  
Miratoi: D.Rroseni

ZV/KRYETARI  
ARMAND SHEHU



**BASHKIA ELBASAN**  
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIAL**  
**SEKTORI I VLERËSIMIT DHE PAGESAVE TË NDIHMËS EKONOMIKE**  
**DHE AFTËSISË SË KUFIZUAR**

**INFORMACION KRAHASUES PËR NDIHMËN EKONOMIKE PËR MUAJIN**  
**JANAR 2025**

**I. Ndhimja ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin SHKURT 2025**

|        |             |       |           |
|--------|-------------|-------|-----------|
| Shkurt | 261 familje | fondi | 2.215.123 |
| Janar  | 246 familje | fondi | 1.144.196 |

Për muajin Shkurt 2025 kemi 15 familje me shume se muaji paraardhes që propozojmë të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi I kushtëzuar.

Fondi i shpenzuar është 1.070.927 lekë më shume se muaji paraardhës.

Familjet e larguara nga ndihma ekonomike nga fondi I kushtëzuar janë:

1. Behexhet Mustafaj (perfitues P.A.K)
2. Rexhep Jolla (nuk paraqitet)
3. Donald Lamçja (nuk paraqitet)
4. Ramazan Rjtonidha (aplikon ne sistem)
5. Besnik Debrova (aplikon ne sistem)
6. Veli Shyti (aplikon ne sistem)
7. Gezim Rrançi (aplikon ne sistem)
8. Vrani Qosja (aplikon ne sistem)
9. Perparim Meta (aplikon ne sistem)
10. Reziana Shehu (nuk paraqitet)
11. Mereme Shkrepi (aplikon ne sistem)

**II. Ndhimja ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin JANAR 2025**

|        |            |       |         |
|--------|------------|-------|---------|
| Shkurt | 81 familje | fondi | 230.000 |
| Janar  | 78 familje | fondi | 211.600 |

Për muajin Shkurt 2025 kemi 3 familje më shume se muaji paraardhes që propozojmë të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i Bashkisë.

Fondi është 18.400 lekë më shume se muaji paraardhës.

Familjet e larguara nga ndihma ekonomike nga fondi I Bashkisë janë :

1. Hekurane Harari (nuk paraqitet)
2. Klea Karaj (aplikon ne sistem)
3. Pren Hazizi (ka dale ne pension)

**Konceptoi**

**Specialiste Ermira Dika**



**Pergjegjese Sektori**

**Miranda Duka**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Elbasan më \_\_\_\_/03/ 2025

**PROJEKT – VENDIM**

Nr. \_\_\_\_ datë \_\_\_\_/03/2025

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin SHKURT 2025**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_/03/2025 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga DPPSSSHKI, bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 24 datë 04.03.2025 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”

**VENDOSI**

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin SHKURT 2025 për 261 familje me një fond prej **1.342.671** lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Drejtori Shërbimit Social D.Shuli  
Drejtori Juridik A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet

A. Merkja

**Sekretar i Këshillit Bashkiak**

**Sokol Sinani**

**Kryetar i Këshillit Bashkiak**

**Lutfi Lala**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA ELBASAN**  
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE RURALE  
DREJTORIA E PYJEVE DHE BUJQËSISË

Nr. 1456 Prot.

Elbasan, më 17.03. 2025

## RELACION

### “PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PARANDALIMIT DHE SHUARJES SË ZJARREVE NË -FONDIN PYJOR KOMBËTAR, BASHKIA ELBASAN”

#### *Të nderuar Këshilltar!*

Administrimi i fondit pyjor dhe kullor në territorin e bashkisë Elbasan, është një funksion i deleguar i bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 22 pika 4 dhe neni 27 pika 5 i këtij ligji ku shprehimisht thuhet: *Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit.*

#### **Baza Ligjore:**

Ligji nr.115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.  
Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.  
Ligji nr.57, datë 30.4.2020 “Për TËNJET”.  
Ligji nr.9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor” i ndryshuar.  
Ligji nr.10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar.  
Ligji nr 152, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”.  
VKM 1080, datë 22.12.2010 “Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota”.

#### • **Definicione**

“Zjarr” është dukuria e djegies, e shoqëruar me nxehtësi të lartë, tym dhe dritë në formë flakësh përcëlluese.

“Zjarr normal” është zjarri që shkakton dëm, për përballimin e të cilit janë të mjaftueshme forcat operacionale, mjetet dhe pajisjet e stacionit zjarrfikës të bashkisë.

“Zjarr masiv” është zjarri që zhvillohet apo tenton të zhvillohet në sipërfaqe e volume të konsiderueshme, për përballimin e të cilit, përveç forcave operacionale, mjeteve e pajisjeve që zotëron shërbimi zjarrfikës i një stacioni, kërkohet edhe pjesëmarrja për ndihmë nga stacionet zjarrfikëse të bashkive të tjera.

“Zjarr me përmasa të mëdha” është zjarri që zhvillohet në sipërfaqe e volume të mëdha, për përballimin e të cilit, përveç forcave operacionale, mjeteve e pajisjeve që zotëron shërbimi zjarrfikës, kërkohet edhe pjesëmarrja, për ndihmë, e forcave e mjeteve të shërbimeve apo strukturave të tjera operuese.

“Organizim i ndërhyrjes në shuarjen e zjarrit dhe shpëtimit” është tërësia e masave tekniko- organizative të nevojshme, për organizimin e forcave të ndryshme, mjeteve, pajisjeve zjarrfikëse, metodave e taktikave, të cilat përdoren për ndërhyrjen në shuarjen e zjarrit, evakuimin dhe shpëtimin e jetës së njerëzve, kafshëve dhe pronës. Një zjarr në pyll është një zjarr me sensibilitet të zgjeruar në zonat pyjore

te mbuluara me shkurre , bimësi pyjore apo pyje të lartë duke përfshirë edhe strukturat e vendosura brenda pyjeve . Objektivi kryesor që duhet të ndiqet është kufizimi i dëmit duke ulur sipërfaqet e mbuluara nga zjarri duke vepruar në drejtim të parandalimit dhe luftës aktive kundër zjarrit në pyje. Parandalimi i zjarreve në pyje duhet të bazohet në njohjen e motiveve dhe të finalizohet duke vepruar në luftën aktive për parandalimin e tyre.

#### **Mbrojtja e pyjeve nga zjarret duhet të bazohet në:**

- Integrimin e veprimeve midis parandalimit dhe zhdukjes së zjarrit.
- Organizimin e shërbimeve të integruara zjarrfikëse me strukturat e tjera të angazhuara në mbrojtjen e pyjeve.

Ligji bazë mbi të cilin kryhet administrimi i fondit pyjor është ligji nr.57/2020 “Për pyjet“, i ndryshuar si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Administrimi dhe menaxhimi i fondit pyjor publik ka kalur në pronësi të Bashkisë Elbasan me VKM nr.433 dt 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike , sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të MM e të ish komunave/bashkive”, i ndryshuar. Në sistemin natyror pyjet dhe kullotat zënë një sipërfaqe të konsiderueshme me vlera ekonomike, mjedisore, rekreative, turistike. Pyjet shpërndahen në të gjithë territorin e bashkisë, por veçanërisht në zonën malore, ku gjenden pyjet e lartë dhe me vlera të larta peizazhike.

Bashkia Elbasan në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, ka nën administrim pyjet dhe kullotat bashkiake, kjo sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, sipërfaqet e pyjeve dhe kullotave të kaluara nën administrim dhe juridiksion të saj janë gjithsej **54979.01 ha**.

Pjesë e këtij administrimi të qëndrueshëm të fondit pyjor/kullosor është edhe mbrojtja e pyjeve nga zjarri. Për këtë arsye në zbatim të dispozitave ligjore, Bashkia Elbasan nëpërmjet Drejtorisë së Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave ka hartuar Planin e Masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor/kullosor për vitin 2025.

Qëllimi i Planit të Masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor/kullosor është ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë pyjore nga zjarret, siç përcaktohet në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet” neni 1 ku specifikisht shprehet *“Mbrojtja e pyjeve si pasuri me rëndësi të veçantë, për vlerat e mëdha dhe të pazëvendësueshme në mbrojtjen e klimës, të tokës, ruajtjen dhe përmirësimin e potencialeve prodhuese, të ekuilibrave të mjedisit natyror, biodiversitetit, burimeve gjenetike dhe regjimit hidrik, si detyrime me interes kombëtar dhe ndërkombëtar”*.

Për të ndjekur këtë qëllim, strategjia e Planit është zhvilluar në tre komponentë të konsoliduar dhe të përhapur edhe në nivel kombëtar dhe Evropian: **parashikimi, parandalimi dhe lufta aktive kundër zjarreve në pyje**, së bashku me atë të trajnimit dhe edukimit mjedisor. Lista e bimëve sipas zonave vertikale bimore bazuar në studime të ndryshme është shumë e gjatë e ndarë në zona si mëposhtë:

- Zona e makjes shtrihet në lartësinë 400-500 m lartësi mbi nivelin e detit. Prej drurëve dhe shkurreve gjethembajtëse, më të përhapura të kësaj zone, janë: ilqja, dëllinja e kuqe, shqopa, ulliri, mareja, dafina etj. Prej drurëve dhe shkurreve gjetherënëse mund të veçojmë: shega, shkoza e zezë, murrizi një bërthamësh, manaferra, driza, krekëza, thanukla, vidhi i bardhë, amorfha shkurre, gjineshtra, frashër uji, frashëri i bardhë, plepi i bardhë, plepi i zi, shelgu i zi, shelgu i kuq, vërr i zi, fiku etj.
- Zona e dushkut shtrihet në lartësitë 300-700 metra mbi nivelin e detit. Llojet më të përhapura të gjinisë Quercus të kësaj zone: bulgëri, qarri, shparthi, etj. Drurë dhe shkurre të tjerë të kësaj



zone janë: panja rrapi, panja mali, panjë, gështenjë, vodhëviçëza, vodha, mëlleza, blini, lajthia, murrizi pesëbërthamësh, dëllinja e zezë etj.

- Zona e ahut ndodhet në lartësitë 600-1700 m mbi nivelin e detit dhe së bashku me nënzonën e pishës shkon deri 1900 m. Në këtë zonë gjenden lloje të drurëve si ahu, panja e malit, si dhe shkurret: borbulli i padhëmbëzuar, mjedra, boronica etj. Nga halorët më shumë gjinden: rrobulli, pisha e zezë e më pak të tjerat.
- Zona e kullotave alpine shtrihet 1800-1900 m mbi nivelin e detit. Disa gjini dhe lloje bimore më të përhapura të kësaj zone janë: trëndafil i egër, samina, shelgu zvarritës, flokësa, bishtpelëza, luluza italiane, këlerie, gentiana pranverore, lulekëmbana, klokëza etj.

Pavarësisht masave të ndërmarra përgjatë viteve, ende theksi nga të gjithë aktorët adresohet tek mbrojtja e pyjeve, duke u përmbledhur në një kërkesë të thjeshtë:

*“Pyllin vetëm mbroje, sepse rritet vetë!”*

Plani i masave parashikon masat që do të merren nga Bashkia Elbasan në bashkëpunim me institucionet e tjera bashkëpunuese për parashikimin, parandalimin, luftimin aktiv dhe trajnimin e personelit dhe jo vetëm.

Ky Plan masash është vjetor dhe është realizuar bazuar në një analizë të thelluar të territorit.

Janë analizuar zonat e territorit dhe periudhat e vitit në të cilat ka më shumë të ngjarë të ndodhë një zjarr i cili është thelbësor për të parandaluar fillimin ose përhapjen e tij.

Për të parandaluar zjarret, të cilat, siç dihet, varen pothuajse ekskluzivisht nga shkaqet njerëzore, nevojitet vetëdijësim që synon respektimin e pyllit, shmangien e qëndrimeve ose veprimeve të rrezikshme dhe për këtë arsye bashkëpunimin aktiv në mbrojtjen e trashëgimisë pyjore.

#### • Zjarret në pyje:

##### - Sipërfaqet e përshkuara/djegura nga zjarri.

Arsyet e rënies së zjarreve janë nga më të ndryshmet, por në bazë të përvojave dhe njohurive të deritanishme në 90 % të rasteve të shfaqjes së këtyre zjarreve si shkak paraqitet njeriu (*direkt ose indirekt*) evidenca e rënies së zjarreve për vitin 2024 e vërteton më së miri këtë fakt. Rrufeja apo vetëndezja e pyjeve kap vetëm 1% të rasteve. Renia e zjarreve në pyje/kullota ku shkaktar është njeriu ndodh nga pakujdesia, padituria, piromania si sëmundje apo qëllim i pastër. Zjarret e shkaktuara nga pakujdesia apo padituria, përfshijnë kryesisht zjarret e shkaktuara nga njerëzit që punojnë në pyje apo kullota të cilët kryejnë punime operationale në këto zona. Këto zjarre ndodhin zakonisht në pranverën e herëshme kur vegjetacioni baror nga viti i kaluar është i thatë dhe vegjetacioni i ri akoma nuk ka filluar. Këtu si shkaktarë të zjarreve janë mbledhësit e frutave pyjore, bimëve medicinale, gjetarët, fremerët apo edhe turistët. Zjarret e qëllimshme bëhen me qëllim që të zgjerojnë tokën e punueshme apo kullotat, ku njeriu ndez zjarrin pa llogaritur pasojat. Motivet e këtyre zjarreve janë nga më të ndryshmet, ato mund të jenë edhe për përfitim ekonomik, për përfitim dru të lirë për dru zjarri apo ndërtim, për të mbuluar prerjet ilegale etj. Klasifikimi i zjarreve në pyje/kullota. Sipas llojeve të zjarreve në pyje mund ti specifikojmë në:

- Zjarr nëntokësor ose nësipërfaqësor
- Zjarr sipërfaqësor ose pranë nëntokës
- Zjarr në kurorat e drurëve
- Zjarr i përgjithshëm ose i kombinuar

Më i përhapur tek ne janë tre rastet e fundit: Zjarri sipërfaqësor është zjarri në të cilin djegia aktive zhvillohet në sipërfaqe të tokës dhe digjet përgjithësisht bimësi pranë tokës në sipërfaqe si bar, filiza, shkurre etj. Në vartësi të kushteve dhe pranisë së erës flakët e zjarrit mund të arrijnë deri në 2m. Në rajonet e rafshëta djegia intensive zakonisht ndjek buzët e zjarrit, ndërsa në zonat kodrinore-malore ajo

zhvillohet në ballin e zjarrit. Shpejtësia e përhapjes së këtij zjarri (pa erë te fortë) mund të arrijë deri në 2.5 km/h.

Faktoret që ndikojnë në rritjen e rrezikut për shfaqjen dhe zhvillimin e zjarreve në pyje.

Më të rëndësishmit janë: -Lloji i bimësisë -Topografia -Stina vjetore -Karakteristikat klimaterike -Komunikacioni

- **Masat për parandalimin e zjarreve në pyje/kullota**

Të gjitha masat që merren për parandalimin e zjarreve sipas kohës kur ndërmeren dhe me çfarë qëllimi, ndahen në :

- a. Masa preventive
- b. Masa përgatitore
- c. Masa direkte

#### **a. Masat preventive**

Janë masa mbrojtje kundër zjarreve që merren vazhdimisht gjatë gjithë vitit. Kjo për shkak se njeriu është shkaktar i tyre në 99% të rasteve edhe këto masa janë të përqëndruara plotësisht ndaj njeriut. Qëllimi final është të parandalohet shkaktimi i zjarreve dhe të zvogëlohet numri i këtyre zjarreve. Në këtë kuadër këto masa janë. Masa ligjore , mbrojtja e pyjeve/kullotave rregullohet me ligje dhe akte nënligjore ku mbrojtja e tyre është përgjegjësi e të gjithëve por edhe e pronarëve ( bashkisë apo subjekteve private) si edhe subjekteve që i menaxhojnë ato. Masat edukative , këto janë masa të cilat në vetvete përfshijnë edukimin e njerëzve dhe përdoren për të gjithë grupmoshat, mgjs më të përdorurat janë për të rinjtë deri në 18 vjet. Mënyrat janë nga më të ndryshmet që nga mësimet në librat shokllorë , leksione të hapura për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret, përdorimi i revistave, fletpalosjeve, internetit tv etj. Masa informative- propagandistike , qëllimi i tyre është për të paralajmëruar dhe informuar njerëzit për rreziqet nga paraqitja e zjarreve në pyje si edhe për të informuar se si duhet të sillemi gjatë qëndrimit në pyll. Kjo masë kombinohet edhe me atë edukative.

#### **b. Masa përgatitore**

Duke patur parasysh që masat preventive nuk e zgjidhin plotësisht problemin e mbrojtjes së pyjeve nga zjarret, është e domosdoshme marrja e masave përgatitore. Këto masa kanë një natyrë të përherëshme gjatë gjithë vitit dhe përfshihen: Zbulimi në kohë i zjarrit, transferimi i informacionit mbi zjarrin, organizimi i zjarrfiksave dhe vullnetarëve, ndërtimi i hendeqeve kundra zjarrit, përgatitja e planit operativ vjetor për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret. Zbulimi në kohë i zjarrit është i një rëndësie të madhe për lokalizimin dhe fikjen shpejt të tij. Zonat tona malore kanë një dukshmëri të dobët, me qëllim që zjarri të mund të zbulohet në kohë organizohet shërbimi i monitorimit në terren nga vëzhguesit kundra-zjarr / vrojtuesve kryesisht me patrullim nga toka në periudhën më të rrezikuar të vitit (*Sipas VKM nr.1080/2010 për 5 muaj*). E rëndësishme për këtë fazë është që nëpërmjet institucioneve qendrore ( *ministri/ agjensi etj*) dhe jo vetëm të kryhet monitorimi nga ajri , mbikqyrje automatike apo elektronike si edhe vëzhgimi satelitor. Masa keto të cilat do të mundësojnë zbulimin dhe monitorimin e këtyre zjarreve. Transferimi i informacionit mbi zjarrin i kryer në mënyrë të shpejtë dhe ka efektin e dëshiruar. Dhënia e këtij informacioni bëhet nëpërmjet telefonit apo edhe sinjalet e tjera si flamuj etj.

***Qytetarët të cilët zbulojnë zjarre në pyje/kullota duhet të njoftojnë në nr. e tel 128 Shërbimin Zjarrfikës .***

Një organizim më i mirë në mënyrën e transferimit të informacionit do të jetë nëpërmjet radiove-lidhese apo ndërtimit të rrjetit të marrje-dhënie nëpërmjet pajisjeve vëzhguese në të gjithë territorin e mbuluar me pyje. Organizimi i zjarrfiksave dhe vullnetarëve deri tek vatra e zjarrit është shumë e rëndësishme për këtë arsye duhet njoftuar menjëherë me zbulimin e zjarrit. Transporti i organizuar i zjarrfiksave dhe pajisjeve mënyra e organizimit të tyre dhe vullnetarëve krijon premisa për menaxhim të mira të situatës së zjarrit. Ndërtimi i hendeqeve kundra zjarrit shërben si si një pozicion mbrojtës për zjarrfikësit por edhe vullnetarët.për këtë arsye hendeqet ekzistuese në pyje duhet të jenë gjatë gjithë

kohës të pastruar nga materiali djegës. Hapja e hendeqeve dhe dimensionimi i tyre (gjerësia) është e ndryshme në vartësi nga lartësia e pemëve, pjerësia e terrenit etj. Psh nëse drurët janë rreth 20m , gjerësia e hendekut do të jetë minimuni 40cm. Përgatitja e planit operativ vjetor për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret

### c. Masa direkte

Pavarësisht nga masat më të mira preventive të marra , zjarret përsëri ndodhin. Për këtë arsye nevojiten masat direkte. Këto janë masa të cilat ndërmerren gjatë kohëzgjatjes së zjarrit dhe synojnë lokalizimin dhe shuarjen e tij. Për të lokalizuar apo shuar një zjarr është e nevojshme të largohet një nga elementet nga i ashtuquajti *trekëndësh i Osborn-it*, përkatësisht materiali djegës , burimi i nxehtësisë apo oksigjeni. Sipas asaj se cili material ose mjet përdoret për këtë qëllim , metodat e shuarjes ndahen në: Shuarje e zjarrit me tokë, metoda më e vjetër e përdorur për këtë qëllim , ku materiali i tokës përdoret si izolator , pra largon elementin oksigjen nga materiali djegës. Toka gjithashtu vepron si një izolant i nxehtësisë , përkatësisht energjia termike për djegien e drurit. Shuarje e zjarrit me ujë, edhe kjo një ndër metodat tradicionale në shuarjen e zjarreve. Veprimi i ujit në procesin e shuarjes është i shumëfishtë. Luftimi i zjarrit me zjarr, megjithëse duket si konfuze, kjo metodë është efektive por mbart në vetvete rrezik dhe kërkon persona të trajnuar dhe me përvojë. Në vartësi të taktikës për lokalizimin dhe shuarjen e zjarrit, në një distancë të caktuar nga zjarri ndizet një “ zjarr i kontrolluar” (*që mund të lëvizë në drejtim të kundërt ose të njëjtë me drejtimin e lëvizjes së zjarrit*) i cili djeg materialin para frontit të zjarrit , kur zjarri arrin në atë sipërfaqe, nuk ka çfarë të djegë dhe zjarri shuhet. Shuarje e zjarrit nga ajri nëpërmjet aeroplanëve është përdorur për herë të parë në vitin 1930. Në përgjithësi kjo është një metodë uji ose kimikatesh , por për shkak të specifikës është e vcurar si metodë e vecante. Është metodë mjaft e shpejtë dhe efikase sidomos për rastet e terrëneve malore . Shuarja e zjarrit me kimikate , në këtë rast përdoren kimikate të ndryshme. Kjo metodë alternohet me atë të ujit sepse në përgjithësi këto kimikate shpërbëhen nëpërmjet ujit. Llogaritet se 70% e ujit që përdoret në shuarjen e zjarreve harxhohet pa efektivitet , për këtë arsye ujit i shtohen kimikate të ndryshme të cilat përmirësojnë efektin e shuarjes së zjarrit. Shuarje e zjarrit me eksploziv, përdoret kryesisht si metodë ndihmëse. Kryesisht për të rrezuar pemë, germim kanalesh, krijim pengesash etj. Në rastet e shpërthimeve krijohet “ re e pluhurit” e cila ul përqindjen e oksigjenit në ajër rrjedhimisht zjarri ul intensitetinose shuhet plotësisht. Veprimet kryesore gjatë zbulimit të zjarrit në pyje/kullota. Detyrë qytetare e çdo individi , në rast se zbulon zjarr në pyll/kullotë, është që të njoftojë sa më shpejt të jetë e mundur institucionet përgjegjëse. Nga shpejtësia e informimit, saktësia dhe përmajtja varet sukcesi i aksionit të shuarjes së zjarrit. Hapat që duhet të ndërmerren janë: **Telefononi nr 128 pa pagesë i Shërbimit Zjarrfikës**. Prezantoni veten me emër e mbiemër. Tregoni se ku jeni ( vendndodhjen e saktë). Tregoni vendndodhjen e zjarrit ( duke dhënë pikat orjentuese sa me të sakta, emrin e vendit , vendbanimit më të afërt apo objekte të njohura). Tregoni llojin e bimësisë që po digjet (dru , shkurre , bar etj) Nëse vëreni dicka të dyshimta afer vatrës së zjarrit psh automjet mundohuni të shënoni targën apo ta mbani mend. Nëse vlerësoni se mund të shuani zjarrin me mjete rrethore atëhere ndërhyini, ne të kundërt largohuni në një distancë të sigurt. Me qëllim që të kuptoheni me personin në telefon jeni të lutur të flisni qartë dhe ngadalë. Informacioni i dhënë në këtë mënyrë është i saktë dhe përmban të gjitha elementet e nevojshme , përcaktimi i vatrës së zjarrit, lloji i materialit djegës, nëse zjarri ka qënë i qëllimshëm etj. Plani i masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor/kullosor.

## Përfundime:

Për sa më sipër bazuar në pikën 4c të nenit 30 të Ligjit nr 57/2020 " Për pyjet" kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë miratimin e "Planit të Masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor/kullosor" për vitin 2025" sipas materialit bashkelidhur.

Duke ju falenderuar !

**KRYETARI**  
Gledian Llatja

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**  
**ZV.KRYETARI**

Asim Sula



Konceptoi: Xh. Muga

Tranoi: J. Bodurri

Miratoi: K. Gripsi

Three handwritten signatures in blue ink are positioned to the right of the names. The top signature corresponds to Xh. Muga, the middle one to J. Bodurri, and the bottom one to K. Gripsi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN

MIRATOHEFT  
ZV/ KRYETARI

Asim Sula



## PROGRAM - PUNJE

MASAT PËR MBROJTJEN, PARANDALIMIN DHE SHUARJEN E ZIARREVE NË FONDIN  
PYJOR E KULLOSOR TË BASHKISË ELBASAN

Drejtori i Drejtorisë së Përgjithëshme së Mbrojtjes Civile, Mjedisit, Bujqësisë, Pyjeve dhe Kollotave  
Shpëtim Çullhaj

Mars - 2025

## BAZA LIGJORE:

- ◆ Ligji Nr. 152/2015, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, neni 7/1, neni 9/b, neni 13/1, i ndryshuar;
- ◆ Ligji Nr.57, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, neni 30, pika 3, 4;
- ◆ Ligji Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 27 pika 5, neni 71, pika c;
- ◆ Ligji Nr.9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor” i ndryshuar;
- ◆ Ligji Nr.10 431, datë 09.06. 2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”;
- ◆ VKM Nr.288, datë 27.06.2002 “Për përcaktimin dhe marrjen e masave kundra zjarrit dhe shpëtimin në objekt me rëndësi ekonomike dhe shetërore”;
- ◆ VKM. Nr. 290, datë 30.04.2004 “Për miratimin e strategjisë kombëtare dhe menaxhimin e zjarreve në pyje e kullota”;
- ◆ VKM Nr.1080, datë 22.12.2010 “Për rregullat në parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota, si dhe për krijimin e njësisve vullnetare të shuarjes së zjarreve”.

Nr.

## MASAT QË DO TË MERRREN

AFATI

ZBATUESI

- Në Bashkinë Elbasan organizohet shtabi i MNZSH-së në nivel Bashkie me këtë përbërje:

| Nr  | Emër e Mbiemër  | Detyra që kryhen   | Funk. në shtab | Nr. telefonit |
|-----|-----------------|--|----------------|---------------|
| 1.  | Asim Sula       | N / Kryetar i Bashkisë   | Kryetar        | 0697288117    |
| 2.  | Shpëtim Çullhaj | Drej. Përgjithshëm i Mbrojtjes Civile, Mjedisit, Bujqësisë, Pyjeve e Kullotave | N /Kryetar     | 0674567988    |
| 3.  | Klaid Gripshi   | Drejtor i Pyjeve dhe Bujqësisë   | Antar          | 0699673721    |
| 4.  | Emrjon Sota     | Drejtor i Drejtorisë së MNZSH-së   | "              | 0694111034    |
| 5.  | Alketa Merkja   | Drejtorë e Drejtorisë së Financës  | "              | 0695558300    |
| 6.  | Everest Dedja   | Drejtor Administrate   | "              | 0698421303    |
| 7.  | Altin Cenolli   | Drejtor Agj. Shërbimeve Publike Rurale   | "              | 0693311212    |
| 8.  | Ndriçim Sinani  | Drejtor Mbrojtjes Civile   | "              | 0694901627    |
| 9.  | Andi Liçi       | Administratror i Nj. Ad Bradashesh   | "              | 0692021097    |
| 10. | Fadil Salla     | Administratror i Nj. Ad. Gracen  | "              | 0688430820    |
| 11. | Oltian Haka     | Administratror i Nj. Ad. Funar   | "              | 0685284991    |
| 12. | Resul Hoxha     | Administratror i Nj. Ad. Gjergjan  | "              | 0686458676    |
| 13. | Emanuel Hida    | Administratror i Nj. Ad. Gjinar  | "              | 0675451320    |
| 14. | Jonuz Qosja     | Administ. e Nj. Ad. Labinot-Fushë  | Antar          | 0682198058    |
| 15. | Ylber Kuci      | Administ. e Nj. Ad. Labinot-Mal  | "              | 0693014065    |
| 16. | Arian Vrapci    | Administratror i Nj. Ad. Papër   | "              | 0685680828    |
| 17. | Ylli Dushku     | Administratror i Nj. Ad. Shirgjan  | "              | 0692777971    |
| 18. | Gëzim Ruda      | Administratror i Nj. Ad. Shushicë  | "              | 0685108604    |
| 19. | Manjola Rexhepi | Administratror e Nj. Ad. Tregan  | "              | 0685320794    |
| 20. | Ervis Dedja     | Administratror i Nj. Ad. Zavallinë   | "              | 0696263545*   |

1.

2. Si rregull, shtabi mblihdet çdo muaj për analizë e informim, por sipas rasis, mblihdet për të analizuar raset e zjarreve e problemeve të ndryshme.

Maj-Tetor

Kryetari i shtabit  
Administratrorët  
Insp. zonave pyjore  
Kryetarët e fshatrave  
DPMCMBPk

|     |  |                        |   |
|-----|--|------------------------|---|
| 3.  | Në Njësitë Administrative Bradashesh, Funar, Gracen, Gjergjan, Gjinar, Labinoth-Fushë, Labinoth-Mal, Papërt, Shirgjan, Shushicë, Tregan, Zavalinë të ngrihen shtabet në nivel lokal, sipas formularit përkatës dhe të sillet një kopje në Bashkinë Elbasan ( <i>Drejtoria e Pyjeve dhe Bujqësisë, pranë ASHPPR</i> ).  |                        | Administratorët<br>Insp. zonave pyjore<br>Kryetarët e fshatrave<br>Drej. Përgjithshëm i Mbrojtjes<br>Civile, Mjedisit, Bujqësisë,<br>Pyjeve e Kullotave<br>(DPMCMBPK) |
| 4.  | Të realizohen takime në NJ.Adm. me pjesëmarrjen e kryetarëve të fshatrave për diskutimin e problemeve të MNZSH-së dhe për organizimin e Skuadrave Vullnetare të MNZSH-së në bazë fshati. Një kopje e dokumentit përkatës të sillet në Bashkinë Elbasan ( <i>Drejtoria e Pyjeve dhe Bujqësisë</i> ). Gjithashtu të organizohet bashkëpunimi dhe me subjektet e ndryshme që do të ushtrojnë aktivitetet në fondin pyjor e kulloror me pronarët e pyjeve private. |                        | Administratorët   |
| 5.  | Nga çdo NJ.Adm. të përcaktohen nevojat për:<br>Mjete e pajisje për shuarjen e zjarreve, qendrat ose vendet ku do të vendosen dhe personat përgjegjës.<br>Tabela propogandistike në shërbim të MNZSH-së.  | Deri më:<br>05.06.2025 | Insp. zonave pyjore<br>DPMCMBPK<br>DPMCMBPK<br>Drejtoria Financës<br>Drejtoria MNZSH-së<br>Drejtoria Emergjencave Civile  |
| 6.  | Agjencia e Shërbimit Publikë Rurale, pasi të studiojë kërkesat të bashkëpunojë me Drejtorinë e Emergjencave Civile, Drejtorinë e MNZSH-së dhe Drejtorinë e Financës etj., për sigurimin e mjeteve e pajisjeve të nevojshme.  |                        | Administratorët<br>Specialisti i pyjeve   |
| 7.  | Nga çdo NJ.Ad. të përcaktohen objektet/zonat pyjore me rrezikshmëri të lartë zjarri dhe të propozojnë nevojat për të vendosur vroitues në periudhën e nevojshme ( <i>Oershor-Terror</i> )  |                        | DPMCMBPK<br>Drejtoria Financës<br>Drejtoria Emergjencave Civile   |
| 8.  | Drejtoritë përgjegjëse në Bashki përcakton fondet e nevojshme për pagesat për shuarjen e zjarreve:<br>- Karburant;<br>- Pagesa e pjesëmarrësve;<br>- të tjera.   | Deri më:<br>15.06.2025 | DPMCMBPK<br>Drejtoria Financës<br>Drejtoria Emergjencave Civile   |
| 9.  | Mbi bazën e të dhënave të grumbulluara nga NJ.Ad. të hartohet Piani i Menaxhimit të Zjarreve në Pyje e Kullota për vitin 2025.   | Deri më:<br>30.06.2025 | Drejtoria Emergjencave Civile   |
| 10. | Sigurimi i bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punës me institucione të Bashkisë:<br>◆ Drejtoria e Emergjencave Civile<br>◆ Drejtoria e MNZSH-së<br>◆ Drejtoria e Financës<br>Dhe me institucionet e tjera, duke siguruar numrat e telefonëve të personave të ngarkuar sipas strukturës specifike të secilit institucion.<br>◆ Drejtoria e Policisë së Shetit  | Deri më:<br>15.06.2025 | Drej. Përgjithshëm i Mbrojtjes<br>Civile, Mjedisit, Bujqësisë,<br>Pyjeve e Kullotave<br>(DPMCMBPK)  |
| 11. | ◆ Drejtoria e Emergjencave Civile në Prefekturë<br>◆ Inspektoriat Kombëtar i Mjedisit dhe Teritorit<br>◆ Bashkitë kufitare: Cërrik, Librazhd, Prenzjas, Pegjin, Gramsh dhe Tiranë.   |                        |   |



|   |                                |   |
|---|--------------------------------|---|
| <p>12.</p> <p>◆ Në bashkëpunim me Prefekturën të përcaktohen (nëse ka) zonat e minuara ose zona me municione të pasgjësuarra. (pika 4.9 e Programit të punës të Ministrisë së Turizmit e Mjedisit e "Për parandalimin dhe mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri për vitin 2025).</p>  | <p>Deri më:<br/>15.07.2025</p> | <p>Drej. Përgjithshëm i Mbrojtjes Civile, Mjedisit, Bujqësisë, Pyjeve e Kullotave (DPMCMBPK).</p> |
| <p>13.</p> <p><b>Masa propagandistike:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>◆ Emissionet televizive në mediat lokale.</li> <li>◆ Njoftimi i mediave lokale për sensibilizimin e popullatës.</li> <li>◆ Artikuj në shtyp.</li> </ul>   | <p>Maj-Tetor<br/>2025</p>      | <p>Shtabi i MNZSH-së</p>  |
| <p>14.</p> <p><b>Organizimi i Shërbimit të MNZSH-së në Bashkinë Elbasan:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>◆ Për periudhën Maj-Tetor organizohet shërbim gatishmërie në zyrën e Informacionit të Bashkisë</li> <li>◆ Përgjegjës për organizimin e shërbimit (hartimin e listës së shërbimit, kontrollin e kryerjes së shërbimit dhe pritjen e përcjelljen e informacionit) është Përgjegjësi i Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Pyjeve.</li> </ul>  | <p>Maj-Tetor<br/>2025</p>      | <p>Shtabi i MNZSH-së.<br/>Përgjegjësi i Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Pyjeve në ASHPR</p>           |
| <p>15.</p> <p>Në Agjencia e Shërbimit Publike Rurale.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>◆ Shërbimi kryhet nga punonjësit e Bashkisë sipas një grafiku të miratuar nga Kryetari i Shtabit të MNZSH-së.</li> <li>◆ Në këtë shërbim nuk përfshihen punonjësit e Agjencia e Shërbimit Publike Rurale.</li> <li>◆ Punonjësit e Drejtorisë së Pyjeve dhe Bujqësisë do të veprojnë në terren për organizimin, koordinimin e kontrollin për shuarjen e zjarrit dhe verifikimin e dëmeve.</li> <li>-Lista, grafiku, ndërtimi i grupeve, funksionimi etj. bëhet me urdhër të Drejtorit të Drejtorisë.</li> <li>◆ Marja dhe përcjellja e informacionit do të bëhet nga punonjësi i shërbimit duke u pasqyruar në një regjistër të posaçëm.</li> <li>◆ Për periudhën Maj-Tetor pranë Agjencia e Shërbimit Publike Rurale, do të jetë në gatishmëri 24 orë një automjet për lëvizjen e personelit që do të marrë pjesë në organizimin e kontrollin e shuarjes së zjarreve.</li> <li>◆ Punonjësi i shërbimit ka për detyrë: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të mbajë në gatishmëri numrin e telefonit që ka të vendosur në këndin e MNZSH-së</li> <li>- Të marrë informacione, t'i përcjellë ata në strukturat përkatëse (në zyrë e në terren) për të siguruar informacionin e nevojshëm dhe merret me organizimin e shuarjes së zjarrit.</li> </ul> </li> <li>- Informon sipas rastit, strukturat sipas SKEMËS SË LAJMERIMIT.</li> </ul> | <p>Maj-Tetor<br/>2025</p>      | <p>Nëpunësi i Shërbimit.</p>  |

|  |                           |  |
|--|---------------------------|--|
| <p><b>Marrja e përcjellja e informacionit.</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>◆ Në këndin e MNZSH-së në Bashki dhe NJ.Ad. të vendosen SKEMAT E LAJMËRIMIT.</li> <li>◆ NJ.Ad. për çdo rast zjarri të njoftojnë menjëherë bashkinë (Shërbimin e gatimishtësisë), Pyjeve në Agjencia e Shërbimit Publike Rurale.</li> <li>◆ Përgjegjësi i Sektorit të Mbrojtjes së Pyjeve në Agjencia e Shërbimit Publike Rurale, pasi ka siguruar të dhënat e nevojshme për vendndodhjen e zjarrit, mundësitë teknike të ndërhyrjes etj. njofton Drejtorinë e MNZSH-së dhe së bashku marrin masat e nevojshme për ndërhyrje.</li> <li>◆ Për çdo rast zjarri nga Përgjegjësi i Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Pyjeve në Agjencia e Shërbimit Publike Rurale, njoftohet: <ul style="list-style-type: none"> <li>a. Agjencia Kombëtare e Pyjeve (AKP) në numër tel. 0699377771.</li> <li>b. Prefektura në numër tel.0694117152</li> <li>c. Policia e Rendit</li> </ul> </li> </ul> | <p>Maj-Tetor<br/>2025</p> | <p>Përgjegjësi i Menaxhimit dhe të Mbrojtjes së Pyjeve në ASHPR.</p> |
| <p>17. ◆ Pasqyrimi në Dokumentet e Kadastrës Pyjore i dëmeve e pasojave të zjarreve bëhet në bazë të dokumentacionit të përgatitur sipas evidencave përkatëse standarte.</p>   | <p>Vazhdimisht</p>        | <p>Specialisti i kadastrës.</p>                                      |





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

**PROJEKT VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ 2025

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PARANDALIMIT DHE SHUARJES SË ZJARREVE  
NË FONDIN PYJOR KOMBËTAR, BASHKIA ELBASAN”**

Në mbështetje të neni 27 pika 5 e ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.152/2015, datë 21.12.2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, i ndryshuar; ligjit nr.57, datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, neni 30 pika 4/c, i ndryshuar; VKM nr.1186, datë 24.12.2020 “Për miratimin e listës së objekteve me rëndësi ekonomike e strategjike, pranë të cilave ngrihen stacionet e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”; VKM nr.290, datë 30.04.2004 “Për Miratimin Strategjik Kombëtar dhe Menaxhimin e Zjarreve në Pyje e Kullota”; VKM nr.1080, datë 22.12.2010 “Për Rregullat në Parandalimin Dhe Shuarjen e Zjarreve në Pyje dhe Kullota si dhe për krijimin e Njësive Vullnetare të Shuarjes së Zjarreve”; VKM nr.433, datë 09.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarëve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, i ndryshuar.

**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDOSI**

1. Miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor kombëtar të bashkisë Elbasan.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria MNZSH së, Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale, Agjencia e Emergjencave Civile, Njësitë Administrative të bashkisë Elbasan dhe Drejtoria e Pyjeve dhe Bujqësisë pranë Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale (ASHPR).
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

**KRYETARI**

**Lutfi Lala**

*Konceptoi:* Xhulian Muça

*Pranoi:* Jakov Bodurri

*Miratoi:* Klajd Gripshi

*Konfirmoi:* Altin Cenolli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE RURALE  
DREJTORIA E PYJEVE DHE BUJQËSISË

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Elbasan, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2025

## RELACION

### “PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PARANDALIMIT DHE SHUARJES SË ZJARREVE NË - FONDIN PYJOR KOMBËTAR, BASHKIA ELBASAN”

#### *Të nderuar Këshilltar!*

Administrimi i fondit pyjor dhe kullor në territorin e bashkisë Elbasan, është një funksion i deleguar i bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 22 pika 4 dhe neni 27 pika 5 i këtij ligji ku shprehimisht thuhet: *Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit.*

#### **Baza Ligjore:**

Ligji nr.1157/014 “Për ndarjen administrative-territoriale të rjesive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Ligji nr.57, datë 30.4.2020 “Për Pyjet”.

Ligji nr.9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor” i ndryshuar.

Ligji nr.10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar.

Ligji nr.152, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”.

VKM 1080, datë 22.12.2010 “Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota”.

#### • **Definicione**

“Zjarr” është dukuria e djegies, e shoqëruar me nxehtësi të lartë, tym dhe dritë në formë flakësh përcëlluese.

“Zjarr normal” është zjarri që shkakton dëm, për përballimin e të cilit janë të mjaftueshme forcat operacionale, mjetet dhe pajisjet e stacionit zjarrfikës të bashkisë.

“Zjarr masiv” është zjarri që zhvillohet apo tenton të zhvillohet në sipërfaqe e volume të konsiderueshme, për përballimin e të cilit, përveç forcave operacionale, mjeteve e pajisjeve që zotëron shërbimi zjarrfikës i një stacioni, kërkohet edhe pjesëmarrja për ndihmë nga stacionet zjarrfikëse të bashkive të tjera.

“Zjarr me përmasa të mëdha” është zjarri që zhvillohet në sipërfaqe e volume të mëdha, për përballimin e të cilit, përveç forcave operacionale, mjeteve e pajisjeve që zotëron shërbimi zjarrfikës, kërkohet edhe pjesëmarrja, për ndihmë, e forcave e mjeteve të shërbimeve apo strukturave të tjera operuese.

“Organizim i ndërhyrjes në shuarjen e zjarrit dhe shpëtimit” është tërësia e masave tekniko- organizative të nevojshme, për organizimin e forcave të ndryshme, mjeteve, pajisjeve zjarrfikëse, metodave e taktikave, të cilat përdoren për ndërhyrjen në shuarjen e zjarrit, evakuimin dhe shpëtimin e jetës së njerëzve, kafshëve dhe pronës. Një zjarr në pyll është një zjarr me sensibilitet të zgjeruar në zonat pyjore

te mbuluara me shkurre , bimësi pyjore apo pyje të lartë duke përfshirë edhe strukturat e vendosura brenda pyjeve . Objektivi kryesor që duhet të ndiqet është kufizimi i dëmit duke ulur sipërfaqet e mbuluara nga zjarri duke vepruar në drejtim të parandalimit dhe luftës aktive kundër zjarrit në pyje. Parandalimi i zjarreve në pyje duhet të bazohet në njohjen e motiveve dhe të finalizohet duke vepruar në luftën aktive për parandalimin e tyre.

#### **Mbrojtja e pyjeve nga zjarret duhet të bazohet në:**

- Integrimin e veprimeve midis parandalimit dhe zhdukjes së zjarrit.
- Organizimin e shërbimeve të integruara zjarrfikëse me strukturat e tjera të angazhuara në mbrojtjen e pyjeve.

Ligji bazë mbi të cilin kryhet administrimi i fondit pyjor është ligji nr.57/2020 “Për pyjet“, i ndryshuar si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Administrimi dhe menaxhimi i fondit pyjor publik ka kalur në pronësi të Bashkisë Elbasan me VKM nr.433 dt 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike-, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të MM e të ish komunave/bashkive”, i ndryshuar. Në sistemin natyror pyjet dhe kullotat zënë një sipërfaqe të konsiderueshme me vlera ekonomike, mjedisore, rekreative, turistike. Pyjet shpërndahen në të gjithë territorin e bashkisë, por veçanërisht në zonën malore, ku gjenden pyjet e lartë dhe me vlera të larta peizazhike.

Bashkia Elbasan në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, ka nën administrim pyjet dhe kullotat bashkiake, kjo sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, sipërfaqet e pyjeve dhe kullotave të kaluara nën administrim dhe juridiksion të saj janë gjithsej **54979.01 ha**.

Pjesë e këtij administrimi të qëndrueshëm të fondit pyjor/kulloror është edhe mbrojtja e pyjeve nga zjarri. Për këtë arsye në zbatim të dispozitave ligjore, Bashkia Elbasan nëpërmjet Drejtorisë së Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave ka hartuar Planin e Masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor/kulloror për vitin 2025.

Qëllimi i Planit të Masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor/kulloror është ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë pyjore nga zjarret, siç përcaktohet në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet” neni I ku specifikisht shprehet “*Mbrojtja e pyjeve si pasuri me rëndësi të veçantë, për vlerat e mëdha dhe të pazëvendësueshme në mbrojtjen e klimës, të tokës, ruajtjen dhe përmirësimin e potencialeve prodhuese, të ekuilibrave të mjedisit natyror, biodiversitetit, burimeve gjenetike dhe regjimit hidrik, si detyrime me interes kombëtar dhe ndërkombëtar*”.

Për të ndjekur këtë qëllim, strategjia e Planit është zhvilluar në tre komponentë të konsoliduar dhe të përhapur edhe në nivel kombëtar dhe Evropian: **parashikimi, parandalimi dhe lufta aktive kundër zjarreve në pyje**, së bashku me atë të trajnimit dhe edukimit mjedisor. Lista e bimëve sipas zonave vertikale bimore bazuar në studime të ndryshme është shumë e gjatë e ndarë në zona si mëposhtë:

- Zona e makjes shtrihet në lartësinë 400-500 m lartësi mbi nivelin e detit. Prej drurëve dhe shkurreve gjethembajtëse, më të përhapura të kësaj zone, janë: ilqja, dëllinja e kuqe, shqopa, ulliri, mareja, dafina etj. Prej drurëve dhe shkurreve gjetherënëse mund të veçojmë: shega, shkoza e zezë, murrizi një bërthamësh, manaferra, driza, krekëza, thanukla, vidhi i bardhë, amorfë shkurre, gjineshtra, frashër uji, frashëri i bardhë, plepi i bardhë, plepi i zi, shelgu i zi, shelgu i kuq, vërrin i zi, fiku etj.
- Zona e dushkut shtrihet në lartësitë 300-700 metra mbi nivelin e detit. Llojet më të përhapura të gjinisë Quercus të kësaj zone: bulgëri, qarri, shparthi, etj. Drurë dhe shkurre të tjerë të kësaj

zone janë: panja rrapi, panja mali, panjë, gështenjë, vodhëviçëza, vodha, mëlleza, blini, lajthia, murrizi pesëbërthamësh, dëllinja e zezë etj.

- Zona e ahut ndodhet në lartësitë 600-1700 m mbi nivelin e detit dhe së bashku me nënzonën e pishës shkon deri 1900 m. Në këtë zonë gjenden lloje të drurëve si ahu, panja e malit, si dhe shkurret: borbulli i padhëmbëzuar, mjedra, boronica etj. Nga halorët më shumë gjinden: rrobulli, pisha e zezë e më pak të tjerat.
- Zona e kullotave alpine shtrihet 1800-1900 m mbi nivelin e detit. Disa gjini dhe lloje bimore më të përhapura të kësaj zone janë: trëndafili i egër, samina, shelgu zvarritës, flokësa, bishtpelëza, luluza italiane, këlerie, gentiana pranverore, lulekëmbana, klokëza etj.

Pavarësisht masave të ndërmarra përgjatë viteve, ende theksi nga të gjithë aktorët adresohet tek mbrojtja e pyjeve, duke u përmbledhur në një kërkesë të thjeshtë:

*“Pyllin vetëm mbroje, sepse rritet vetë!”*

Plani i masave parashikon masat që do të merren nga Bashkia Elbasan në bashkëpunim me institucionet e tjera bashkëpunuese për parashikimin, parandalimin, luftimin aktiv dhe trajnimin e personelit dhe jo vetëm.

Ky Plan masash është vjetor dhe është realizuar bazuar në një analizë të thelluar të territorit.

Janë analizuar zonat e territorit dhe periudhat e vitit në të cilat ka më shumë të ngjarë të ndodhë një zjarr i cili është thelbësor për të parandaluar fillimin ose përhapjen e tij.

Për të parandaluar zjarret, të cilat, siç dihet, varen pothuajse ekskluzivisht nga shkaqet njerëzore, nevojitet vetëdijësim që synon respektimin e pyllit, shmangien e qëndrimeve ose veprimeve të rrezikshme dhe për këtë arsye bashkëpunimin aktiv në mbrojtjen e trashëgimisë pyjore.

#### • Zjarret në pyje:

##### - Sipërfaqet e përshkuara/djegura nga zjarri.

Arsyet e rënies së zjarreve janë nga më të ndryshmet, por në bazë të përvojave dhe njohurive të deritanishme në 90 % të rasteve të shfaqjes së këtyre zjarreve si shkak paraqitet njeriu (*direkt ose indirekt*) evidenca e rënies së zjarreve, për vitin 2024 e vërteton më së miri këtë fakt. Rrufeja apo vetëndezja e pyjeve kap vetëm 1% të rasteve. Rënia e zjarreve në pyje/kullota ku shkaktar është njeriu ndodh nga pakujdesia, padituria, piromania si sëmundje apo qëllim i pastër. Zjarret e shkaktuara nga pakujdesia apo padituria, përfshijnë kryesisht zjarret e shkaktuara nga njerëzit që punojnë në pyje apo kullota të cilët kryejnë punime operacionale në këto zona. Këto zjarre ndodhin zakonisht në pranverën e herëshme kur vegetacioni baror nga viti i kaluar është i thatë dhe vegetacioni i ri akoma nuk ka filluar. Këtu si shkaktarë të zjarreve janë mbledhësit e frutave pyjore, bimëve medicinale, gjetarët, fremerët apo edhe turistët. Zjarret e qëllimshme bëhen me qëllim që të zgjerojnë tokën e punueshme apo kullotat, ku njeriu ndez zjarrin pa llogaritur pasojat. Motivet e këtyre zjarreve janë nga më të ndryshmet, ato mund të jenë edhe për përfitim ekonomik, për përfitim dru të lirë për dru zjarri apo ndërtim, për të mbuluar prerjet ilegale etj. Klasifikimi i zjarreve në pyje/kullota. Sipas llojeve të zjarreve në pyje mund ti specifikojmë në:

- Zjarr nëntokësor ose nësipërfaqësor
- Zjarr sipërfaqësor ose pranë nëntokës
- Zjarr në kurorat e drurëve
- Zjarr i përgjithshëm ose i kombinuar

Më i përhapur tek ne janë tre rastet e fundit: Zjarri sipërfaqësor është zjarri në të cilin djegia aktive zhvillohet në sipërfaqe të tokës dhe digjet përgjithësisht bimësi pranë tokës në sipërfaqe si bar, filiza, shkurre etj. Në vartësi të kushteve dhe pranisë së erës flakët e zjarrit mund të arrijnë deri në 2m. Në rajonet e rafshëta djegia intensive zakonisht ndjek buzët e zjarrit, ndërsa në zonat kodrinore-malore ajo

zhvillohet në ballin e zjarrit. Shpejtësia e përhapjes së këtij zjarri (pa erë te fortë) mund të arrijë deri në 2.5 km/h.

Faktoret që ndikojnë në rritjen e rrezikut për shfaqjen dhe zhvillimin e zjarreve në pyje.

Më të rëndësishmit janë: -Lloji i bimësisë -Topografia -Stina vjetore -Karakteristikat klimaterike -Komunikacioni

- **Masat për parandalimin e zjarreve në pyje/kullota**

Të gjitha masat që merren për parandalimin e zjarreve sipas kohës kur ndërmeren dhe me çfarë qëllimi, ndahen në :

- a. *Masa preventive*
- b. *Masa përgatitore*
- c. *Masa direkte*

#### **a. Masat preventive**

Janë masa mbrojtje kundër zjarreve që merren vazhdimisht gjatë gjithë vitit. Kjo për shkak se njeriu është shkaktar i tyre në 99% të rasteve edhe këto masa janë të përqëndruara plotësisht ndaj njeriut. Qëllimi final është të parandalohet shkaktimi i zjarreve dhe të zvogëlohet numri i këtyre zjarreve. Në këtë kuadër këto masa janë. Masa ligjore , mbrojtja e pyjeve/kullotave rregullohet me ligje dhe akte nënligjore ku mbrojtja e tyre është përgjegjësi e të gjithëve por edhe e pronarëve ( bashkisë apo subjekteve private) si edhe subjekteve që i menaxhojnë ato. Masat edukative , këto janë masa të cilat në vetvete përfshijnë edukimin e njerëzve dhe përdoren për të gjithë grupmoshat, mgjs më të përdorurat janë për të rinjtë deri në 18 vjet. Mënyrat janë nga më të ndryshmet që nga mësimet në librat shokllorë , leksione të hapura për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret, përdorimi i revistave, fletpalosjeve, internetit tv etj. Masa informative- propagandistike , qëllimi i tyre është për të paralajmëruar dhe informuar njerëzit për rreziqet nga paraqitja e zjarreve në pyje si edhe për të informuar se si duhet të sillemi gjatë qëndrimit në pyll.Kjo masë kombinohet edhe me atë edukative.

#### **b. Masa përgatitore**

Duke patur parasysh që masat preventive nuk e zgjidhin plotësisht problemin e mbrojtjes së pyjeve nga zjarret, është e domosdoshme marrja e masave përgatitore. Këto masa kanë një natyrë të përhershme gjatë gjithë vitit dhe përfshihen: Zbulimi në kohë i zjarrit, transferimi i informacionit mbi zjarrin, organizimi i zjarrfiksave dhe vullnetarëve, ndërtimi i hendeqeve kundra-zjarrit, përgatitja e planit operativ vjetor për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret. Zbulimi në kohë i zjarrit është i një rëndësie të madhe për lokalizimin dhe fikjen shpejt të tij. Zonat tona malore kanë një dukshmëri të dobët, me qëllim që zjarri të mund të zbulohet në kohë organizohet shërbimi i monitorimit në terren nga vëzhguesit kundra-zjarr / vrojtuesve kryesisht me patrullim nga toka në periudhën më të rrezikuar të vitit (*Sipas VKM nr.1080/2010 për 5 muaj*). E rëndësishme për këtë fazë është që nëpërmjet institucioneve qëndrore ( *ministri/ agjensi etj*) dhe jo vetëm të kryhet monitorimi nga ajri , mbikqyrje automatike apo elektronike si edhe vëzhgimi satelitor. Masa keto të cilat do të mundësojnë zbulimin dhe monitorimin e këtyre zjarreve. Transferimi i informacionit mbi zjarrin i kryer në mënyrë të shpejtë dhe ka efektin e dëshiruar. Dhënia e këtij informacioni bëhet nëpërmjet telefonit apo edhe sinjalet e tjera si flamuj etj.

***Qytetarët të cilët zbulojnë zjarre në pyje/kullota duhet të njoftojnë në nr. e tel 128 Shërbimin Zjarrfikës .***

Një organizim më i mirë në mënyrën e transferimit të informacionit do të jetë nëpërmjet radiove-lidhese apo ndërtimit të rrjetit të marrje-dhënie nëpërmjet pajisjeve vëzhguese në të gjithë territorin e mbuluar me pyje. Organizimi i zjarrfiksave dhe vullnetarëve deri tek vatra e zjarrit është shumë e rëndësishme për këtë arsye duhet njoftuar menjëherë me zbulimin e zjarrit. Transporti i organizuar i zjarrfiksave dhe pajisjeve mënyra e organizimit të tyre dhe vullnetarëve krijon premisa për menaxhim të mira të situatës së zjarrit. Ndërtimi i hendeqeve kundra zjarrit shërben si si një pozicion mbrojtës për zjarrfikësit por edhe vullnetarët.për këtë arsye hendeqet ekzistuese në pyje duhet të jenë gjatë gjithë

kohës të pastruar nga materiali djegës. Hapja e hendeqeve dhe dimensionimi i tyre (gjerësia) është e ndryshme në vartësi nga lartësia e pemëve, pjerësia e terrenit etj. Psh nëse drurët janë rreth 20m , gjerësia e hendekut do të jetë minimuni 40cm. Përgatitja e planit operativ vjetor për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret

### c. Masa direkte

Pavarësisht nga masat më të mira preventive të marra , zjarret përsëri ndodhin. Për këtë arsye nevojiten masat direkte. Këto janë masa të cilat ndërmerren gjatë kohëzgjatjes së zjarrit dhe synojnë lokalizimin dhe shuarjen e tij. Për të lokalizuar apo shuar një zjarr është e nevojshme të largohet një nga elementet nga i ashtuquajti *trekëndësh i Osborn-it*, përkatësisht materiali djegës , burimi i nxehtësisë apo oksigjeni. Sipas asaj se cili material ose mjet përdoret për këtë qëllim , metodat e shuarjes ndahen në: Shuarje e zjarrit me tokë, metoda më e vjetër e përdorur për këtë qëllim , ku materiali i tokës përdoret si izolator , pra largon elementin oksigjen nga materiali djegës. Toka gjithashtu vepron si një izolant i nxehtësisë , përkatësisht energjia termike për djegien e drurit. Shuarje e zjarrit me ujë, edhe kjo një ndër metodat tradicionale në shuarjen e zjarreve. Veprimi i ujit në procesin e shuarjes është i shumëfishtë. Luftimi i zjarrit me zjarr, megjithëse duket si konfuze, kjo metodë është efektive por mbart në vetvete rrezik dhe kërkon personë të trajnuar dhe me përvojë. Në vartësi të taktikës për lokalizimin dhe shuarjen e zjarrit, në një distancë të caktuar nga zjarri ndizet një “ zjarr i kontrolluar” (*që mund të lëvizë në drejtim të kundërt ose të njëjtë me drejtimin e lëvizjes së zjarrit*) i cili djeg materialin para frontit të zjarrit , kur zjarri arrin në atë sipërfaqe, nuk ka cfarë të djegë dhe zjarri shuhet. Shuarje e zjarrit nga ajri nëpërmjet aeroplanëve është përdorur për herë të parë në vitin 1930. Në përgjithësi kjo është një metodë uji ose kimikatesh , por për shkak të specifikës është e vuar si metodë e vecante. Është metodë mjaft e shpejtë dhe efikase sidomos për rastet e tërreneve malore . Shuarja e zjarrit me kimikate , në këtë rast përdoren kimikate të ndryshme. Kjo metodë alternohet me atë të ujit sepse në përgjithësi këto kimikate shpërbëhen nëpërmjet ujit. Llogaritet se 70% e ujit që përdoret në shuarjen e zjarreve harxhohet pa efektivitet , për këtë arsye ujit i shtohen kimikate të ndryshme të cilat përmirësojnë efektin e shuarjes së zjarrit. Shuarje e zjarrit me eksploziv, përdoret kryesisht si metodë ndihmëse. Kryesisht për të rrezuar pemë, gjermim kanalesh, krijim pengesash etj. Në rastet e shpërthimeve krijohet “ re e pluhurit” e cila ul përqindjen e oksigjenit në ajër rrjedhimisht zjarri ul intensitetinose shuhet plotësisht. Veprimet kryesore gjatë zbulimit të zjarrit në pyje/kullota. Detyrë qytetare e çdo individi , në rast se zbulon zjarr në pyll/kullotë, është që të njoftojë sa më shpejt të jetë e mundur institucionet përgjegjëse. Nga shpejtësia e informimit, saktësia dhe përmajtja varet suksesi i aksionit të shuarjes së zjarrit. Hapat që duhet të ndërmerren janë: **Telefononi nr 128 pa pagesë i Shërbimit Zjarfikës**. Prezantoni veten me emër e mbiemër. Tregoni se ku jeni ( vendndodhjen e saktë). Tregoni vendndodhjen e zjarrit ( duke dhënë pikat orjentuese sa me të sakta, emrin e vendit , vendbanimit më të afërt apo objekte të njohura). Tregoni llojin e bimësisë që po digjet (dru , shkurre , bar etj) Nëse vëreni dicka të dyshimtë afer vatrës së zjarrit psh automjet mundohuni të shënoni targën apo ta mbani mend. Nëse vlerësoni se mund të shuani zjarrin me mjete rrethore atëhere ndërhyuni, në të kundërt largohuni në një distancë të sigurt. Me qëllim që të kuptoheni me personin në telefon jeni të lutur të flisni qartë dhe ngadalë. Informacioni i dhënë në këtë mënyrë është i saktë dhe përmban të gjitha elementet e nevojshme , përcaktimi i vatrës së zjarrit, lloji i materialit djegës, nëse zjarri ka qënë i qëllimshëm etj. Plani i masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor/kullosor.




## Përfundime:

Për sa më sipër bazuar në pikën 4c të nenit 30 të Ligjit nr 57/2020 " Për pyjet" kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë miratimin e "Planit të Masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor/kullosor" për vitin 2025" sipas materialit bashkelidhur.

Duke ju falenderuar !

**KRYETARI**  
Gledian Llatja


**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**  
**ZV.KRYETARI**  
Asim Sula



Konceptoi: Xh. Muci

Trahoi: P. Boduri

Miratoi: K. Gripi





**RËPUBLIKA Ë SHQIPËRISË**  
**BASHKIA ËLBASAN**  
**AGJËNCIA SHËRBIMËVË PUBLIKË RURALË**

Nr. 1586 Prot

Dt. 25.03 2025

**RELACION**

**Për një ndryshim në VKB Nr. 16. Dt. 29.01.2025 “Për miratimin e normave dhe kritereve për disiplinimin e shpenzimeve për mjete motorrike në administrim të ASHPR, SHMZZH, QSB”.**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vërtëqeverisjen vendore”, neni 54, të ligjit nr.115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Rëpublikën ë Shqipërisë”, të ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Komisioni për përcaktimin e normativave të mjeteve motorrike per vitin 2025 me Nr. 1 Dt. 07.01.2025 konstatoi se në vendimin Nr. 16 Dt.

**29.01.2025 “Për miratimin e normave dhe kritereve për disiplinimin e shpenzimeve për mjete motorrike në administrim të ASHPR, SHMZZH, QSB” kishte ndodhur nje lapsus per mjetin Tip Mercedes Benz me targë AB968OC, pasi në proces verbalin e percaktimit të normatives Dt. 13.01.2025 ky automjet e kishte normativen 14Lt /100km me limit maksimal 300 Lt ne muaj por gabimisht ne hartimin e tabelës ishte shënuar limiti 200 Litra/muaj.**

Duke parë llojin e mjetit dhe natyrën e përdorimit të tij propozohet që të bëhet korigjimi përkatës në dokumentacionin zyrtar dhe të miratohët vendimi i ri për të reflektuar limitin e saktë të konsumit mujor prej 300 litrash.

Kjo ndryshon në përputhje me analizën teknike dhe kërkesat e shërbimeve operacionale të ndërmarrjes tonë.

Ky korigjim të miratohet nga Këshilli Bashkiak dhe të reflektohet në të gjitha aktet përkatëse administrative.

Konceptoi: S.Finance Drilona Mema  
P/Sek mekanik Gazmend Gaxhja  
Pranoi: Dr. Pergj Altin Cenolli

**Miratoi**  
Kryetari  
Gledjan Llatja



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA ELBASAN**  
**AGJENCIA SHERBIMEVE PUBLIKE RURALE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Dt. \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2025

**PROJEKT VENDIM**

**Për një ndryshim në VKB Nr. 16. Dt. 29.01.2025 “Për miratimin e normave dhe kriterëve për disiplinimin e shpenzimeve për mjete motorrike në administrim të ASHPR, SHMZZH, QSB”.**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54, të ligjit nr.115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njëjësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Këshilli i Bashkisë Elbasan, pasi mori në shqyrtim Relacionin e paraqitur nga Agjencia e Shërbimeve Publike Elbasan, në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_\_

**VENDOSI:**

- 1.Të miratojë limitin e konsumit mujor të karburantit për mjetin tip Mercedes Benz AB968OC ku normativa mujore është përkatësisht: **14 Litra/100 Km-Limit Mujor/300 Litra Gazoil D1.**
- 2.Ngarkohet Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konceptoi:S.Finance Drilona Mema

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**  
**Sokol Sinani**

**Kryetari i Këshillit Bashkiak**  
**Lutfi Lala**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
AGJENCIA SHERBIMEVE PUBLIKE RURALE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Dt. \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 2025

PROCES VERBAL

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore; në Ligjin Nr 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" për nevojat e përdorimit racional dhe të përditshëm të karburantit

Mbahet ky procesverbal në prani të komisionit të ngritur me urdhërin Nr 1 datë 07.01.2025

Anetarët e komisionit:

- Gazmend Gaxhja
- Drilona Mema
- Englantina Hoxha

Në bazë të verifikimit të fakteve dhe provave konkludohet si më poshtë :

- Automjeti tip **Mercedes Benz** me targë **AB968OC** për 100 km të përshkruar harxhon **14 litra** Gazoil D1

Në përcaktimin e normativave u mbajten parasysh normativat egzistuese, disa tregues të rëndësishëm sic jane viti i prodhimit , tipi e lloji i mjetit, amortizimi i tij, gjendja reale teknike e mjetit, rrugët që do të përshkohen, ndalesa në semafore, trafiku në qytet, natyra e punës për makinerinë e rënde, nevojat e përdorimit të funksioneve shtesë etj.

Këto normativa do të zbatohen për periudhën **01.01.2025-31.12.2025**

KOMISION

Gazmend Gaxhja

Drilona Mema

Englantina Hoxha

DREJTOR I PERGJITHSHEM

Altin Cepolli

**AGJENCIA E SHERBIMEVE PUBLIKE RURALE**

**NORMATIVAT DHE KUOTAT MUJORE TE HARXHIMIT TE KARBURANTIT PER VITIN 2025.**

**ADMINISTRATA**

| Nr | Targa e mjetit | Tipi I mjetit        | Norma e konsumit                         | Karburanti |
|----|----------------|----------------------|--|------------|
| 1  | AB357NH        | VoLkswagen<br>Amarok | 12 Litra/100 km<br>Limit mujor/200 Litra | GazoiL D1  |
| 2  | AA745GB        | Mercedez Benz        | 10 Litra/100 km<br>Limit mujor/300 Litra | GazoiL D1  |
| 3  | AB968OC        | Mercedez Benz        | 14 Litra/100 km<br>Limit mujor/300 Litra | GazoiL D1  |
| 4  | AA151MD        | VoLkswagen           | 9 Litra/100 km<br>Limit mujor/300 Litra  | GazoiL D1  |

| Nr | Targa e mjetit | Tipi I mjetit                | Norma e konsumit | Karburanti |
|----|----------------|------------------------------|------------------|------------|
|    |                | <b>AUTOVINCAT</b>            |                  |            |
| 5  | AB739OC        | Autovinc Benz                | 10 Litra /orë    | GazoiL D1  |
|    |                | <b>FADROMAT</b>              |                  |            |
| 6  | AJMT23         | Fadrome Komatcu              | 9 Litra /orë     | GazoiL D1  |
| 7  | AB033OD        | Fadrome JCB                  | 8 Litra /orë     | GazoiL D1  |
| 8  | AB132BE        | Fadrome Fiat Hitaci          | 8 Litra /orë     | GazoiL D1  |
| 9  | W 130          | Fadrome Fiat KobeLco<br>W130 | 10 Litra/orë     | GazoiL D1  |
| 10 | ANMT95         | Fadrome HIDROMEK             | 9 Litra/orë      | GazoiL D1  |
|    |                | <b>KAMIONCINAT</b>           |                  |            |
| 11 | AB773CK        | Kamioncine ford transit      | 12 Litra /100 km | GazoiL D1  |

|    |           | <b>FUORISTRADAT</b>               |  |           |
|----|-----------|-----------------------------------|--|-----------|
| 12 | AA150HY   | Mitsubishi Fuoristrade            | 13 Litra / 100 km                        | Gazoil D1 |
| 13 | AB414PE   | Toyota ILUX                       | 12 Litra/100 km                          | Gazoil D1 |
|    |           | <b>ESKAVATOR</b>                  |  |           |
| 14 | ECR 88    | Eskavator VoLvo ECR 88            | 7 Litra/orë                              | Gazoil D1 |
| 15 | AOMT53    | Eskavator me goma FIAT<br>HITACHI | 17 Litra/orë                             | Gazoil D1 |
| 16 | EX-220 LC | Eskavator Hitachi EX-<br>220Lc    | 22 Litra/orë                             |           |
| 17 | ET-18     | Mini Eskavator ET-18              | 3.5 Litra/orë                            | Gazoil D1 |
|    |           | <b>TRAKTOR</b>                    |  |           |
| 18 | FD 30     | BuLdozer kobelko                  | 20 Litra/orë                             | Gazoil D1 |
| 19 | FT-125    | Traktor FT 125                    | 22 Litra/orë                             | Gazoil D1 |
|    |           | <b>KAMIONAT</b>                   |  |           |
| 20 | EL5513B   | Makine Kamion Benz                | 35 Litra / 100 km                        | Gazoil D1 |
| 21 | EL5509B   | Makine Kamion Benz                | 35 Litra / 100 km                        | Gazoil D1 |
| 22 | EL1427C   | Makine Kamion Benz                | 35 Litra / 100 km                        | Gazoil D1 |
| 23 | AB131BE   | Kamion man                        | 40Litra /100 km                          | Gazoil D1 |
| 24 | AB954SA   | Iveco C35/-11A                    | 12 Litra/100 km                          | Gazoil D1 |
| 25 | AB650SA   | Kamion Man T34                    | 40 Litra/100 km                          | Gazoil D1 |
|    |           | <b>MAKINAT E<br/>PASTRIMIT</b>    |  |           |
| 26 | AA013VL   | Makine Pastrimi Iveco             | 4 Litra /orë                             | Gazoil D1 |
| 27 | AA014VL   | Makine Pastrimi Iveco             | 4 Litra /orë                             | Gazoil D1 |
| 28 | AB236HS   | Makine pastrimi Iveko             | 3.5 Litra/orë                            | Gazoil D1 |
| 29 | AB320HS   | Makine pastrimi FORD              | 5 Litra/orë                              | Gazoil D1 |
|    |           | <b>KARROTREC</b>                  |  |           |
| 30 | AB760OC   | Karrotrec                         | 22 Litra/100 km<br>Limit mujor 150 Litra | Gazoil D1 |
| 31 |           | Rul deri 12.90T                   | 12 Litra/orë                             | Gazoil D1 |
| 32 |           | RuL deri 12.9T( vibrim)           | 20 L/me vibrim                           | Gazoil D1 |
| 33 |           | RuL I vogel pioneer               | 3 Litra/orë                              | Gazoil D1 |

**SHERBIMI PYJOR**

| Nr | Targa e mjetit | Tipi I mjetit    | Norma e konsumit                           | Karburanti |
|----|----------------|------------------|--|------------|
| 34 | AA 060 DJ      | Toyota RAV 4     | 12 Litra/100 km<br>Limit mujor 100 Litra   | Gazoil D1  |
| 35 | EL 0738 C      | Land Rover       | 14.4 Litra/100 km<br>Limit mujor 150 Litra | Gazoil D1  |
| 36 | AB 589 RA      | Nisan Pathfinder | 14 Litra/100 km<br>Limit mujor 100 Litra   | Gazoil D1  |
| 37 | AB 648 PT      | VoLvo CX-60      | 11 Litra/100 km<br>Limit mujor 100 Litra   | Gazoil D1  |

**POLICIA BASHKIAKE**

| Nr | Targa e mjetit | Tipi I mjetit         | Norma e konsumit                           | Karburanti |
|----|----------------|-----------------------|--|------------|
| 38 | EL8732A        | Mitsubishi Pajero     | 13.5 Litra/100 km<br>Limit mujor 300 Litra | Gazoil D1  |
| 39 | AB560DF        | KIA                   | 6.4 Litra /100 km<br>Limit mujor 200 Litra | Benzine    |
| 40 | AB536DF        | Pick up<br>VoLkswagen | 12 Litra /100 km<br>Limit mujor/300 Litra  | Gazoil D1  |

**IMT**

| Nr | Targa e mjetit | Tipi I mjetit | Norma e konsumit                         | Karburanti |
|----|----------------|---------------|--|------------|
| 41 | IMT AB976OC    | Benz Mercedes | 10 Litra/100 km<br>Limit mujor/200 Litra | Gazoil D1  |
| 42 | AB711OC        | Mitsubishi    | 20 Litra/100 km<br>Limit mujor/200 Litra | Benzine    |

| Nr |  | MJETE MOTORRIKE                    | Norma e konsumit | Karburanti                      |
|----|--|------------------------------------|------------------|---------------------------------|
| 1  |  | Gjenerator 10 kw                   | 0.7 L/orë        | Gazoil D1                       |
| 2  |  | Motorseke                          | 0.6 L/orë        | Benzine                         |
| 3  |  | Korse Bari                         | 0.5 L/100 m2     | Benzine                         |
| 4  |  | Motorrsaldatrice IANCIU            | 1.5L/orë         | Benzine                         |
| 5  |  | Gjenerator i paisjeve te shpetimit | Benzine          | Per 1 orë pune<br>1.5 L/Benzine |
| 6  |  | Motorsharre StihL                  | Benzine          | Per 1 orë pune<br>1.5L/Benzine  |
| 7  |  | Trako per prerje betoni dhe metaLe | Benzine          | Per 1 orë pune<br>1.5L/Benzine  |
| 8  |  | VentiLator per pastrimin e tymit   | Benzine          | Per 1 ore pune<br>1.5L/Benzine  |
| 9  |  | Pompe thithese uji Lambordini      | Diesel D1        | Per 1 orë pune<br>5 L/Benzine   |
| 10 |  | Pompe thithese uji Mitsubishi      | Benzine          | Per 1 orë pune<br>3 L/Benzine   |

#### ADMINISTRATORET

| Nr | Targa e mjetit | Tipi I mjetit | Norma e konsumit                       | Karburanti |
|----|----------------|---------------|--|------------|
| 1  | AA579EC        | Volkswagen    | 8 Litra/100 Km<br>Limit mujor/50 Litra | Benzine    |
| 2  | AA140HM        | Autoveture    | 7 Litra/100 Km<br>Limit mujor/50 Litra | Benzine    |
| 3  | AB489NC        | HYUNDAI       | 8 Litra/100 Km<br>Limit mujor/50 Litra | Gazoil D1  |
| 4  | AB446IO        | Mercedes Benz | 8 Litra/100 Km<br>Limit mujor/50 Litra | Gazoil D1  |
| 5  | AB448AB        | Auto Volksw.  | 9 Litra/100 Km<br>Limit mujor/50 Litra | Gazoil D1  |
| 6  | AB869EE        | Auto Opel     | 7 Litra/100 Km<br>Limit mujor/50 Litra | Gazoil D1  |



|    |         |                      |  |           |
|----|---------|----------------------|--|-----------|
| 7  | AA171OE | Auto Ford            | 6 Litra/100 Km<br>Limit mujor/50 Litra | Gazoil D1 |
| 8  | AA184UZ | Wolkswagen<br>Passat | 8 Litra/100 Km<br>Limit mujor/50 Litra | Gazoil D1 |
| 9  | AA628KD | Auto Ford            | 5 Litra/100 Km<br>Limit mujor/50 Litra | Gazoil D1 |
| 10 | AB175FF | Nissan               | 6 Litra/100 km<br>Limit mujor/50 Litra | Gazoil D1 |
| 11 | AA950KC | DamiLer<br>ChrysLer  | 8 Litra/100 km<br>Limit mujor/50 Litra | Gazoil D1 |
| 12 | AB029ER | Mercedes Benz        | 8 Litra/100 km<br>Limit mujor/50 Litra | Gazoil D1 |

**ZJARRFIKESJA**

| Nr | Targa e mjetit | Tipi I mjetit       | Norma e konsumit   | Karburanti |
|----|----------------|---------------------|--|------------|
| 1  | AA152UZ        | Benz 1222           | 30 Litra/100 km<br>Për 1 orë pune dhe 1 orë ndezje<br>në vënd 12 Litra | Gazoil D1  |
| 2  | AA153UZ        | Benz 1117           | 17 Litra/100 km<br>Për 1 orë pune dhe 1 orë ndezje<br>në vënd 9 Litra  | Gazoil D1  |
| 3  | AA154UZ        | Benz Autoskalle     | 27 Litra/100 km<br>Për 1 orë pune dhe 1 orë ndezje<br>në vënd 10 Litra | Gazoil D1  |
| 4  | AA155UZ        | Reno S 150 Midliner | 20 Litra/100 km<br>Për 1 orë pune dhe 1 orë ndezje<br>në vënd 9 Litra  | Gazoil D1  |
| 5  | AA156UZ        | Renault Unimong     | 33 Litra/100 km<br>Për 1 ore pune dhe 1 orë ndezje<br>në vënd 12 Litra | Gazoil D1  |
| 6  |                | Iveko               | 33 Litra/100 km<br>Për 1 orë pune dhe 1 orë ndezje<br>në vënd 14 Litra | Gazoil D1  |

**MJETE MOTORRIKE**

| Nr | Mjete motorrike                         | Norma e konsumit | Karburanti |
|----|---|------------------|------------|
| 1  | Gjeneratorët e paisjeve<br>të shpëtimit | 1.5L/orë         | Benzine    |
| 2  | Motorrsharrë Stihl                      | 1.5L/orë         | Benzine    |

|   |  |                                    |          |           |
|---|--|------------------------------------|----------|-----------|
| 3 |  | Trako për prerje betoni dhe metale | 1.5L/orë | Benzine   |
| 4 |  | Ventilator për pastrimin e tymit   | 1.5L/orë | Benzine   |
| 5 |  | Pompë thithëse uji Lambordini      | 5L/orë   | Gazoil D1 |
| 6 |  | Pompë thithëse uji Mitsubishi      | 3L/orë   | Benzine   |

#### QENDRA SOCIALE BALASHE

| Nr | Targa e mjetit | Tipi I mjetit   | Norma e konsumit | Karburanti       |
|----|----------------|-----------------|------------------|------------------|
| 1  | EL 4389 C      | Benz            | Gazoil D1        | 15litra /100 km  |
| 2  | AA 382 FY      | OPEL VIVARO     | Gazoil D1        | 13 lit /100 km   |
| 3  | AA 107 SY      | Volkswagen Cady | Gazoil D1        | 15 litra /100 km |

Konceptoi: Drilona Mema

Pergj/Sekt.Mekanik :

Gazmend Gaxhja

**Miratoi:**

Drejtor I Përgjithshëm

Altin Cençlli



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE RURALE**

Nr. 1584 Prot.

Elbasan, më 25.03. 2025.

**Lënda:**Relacion Për transferimin e automjetit “Autoveture e Re Elektrik VW ID4 LFVVB9E66P5006604 me targa AB645PX ,nga Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale në Agjencinë e Shërbimeve Publike Urbane

**KËSHILLIT BASHKIAK**

**BASHKIA ELBASAN**

Në zbatim të neneve 8, 9, 64 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Ligjit 10296 dt.08,07,2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar,

VKB nr.82 dt.13.09.2023 ‘’ Për krijimin e Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale dhe atë të Shërbimeve Urbane’’ si dhe Urdhërit Administrativ të Kryetarit të Bashkisë nr. 8 dt.09,01,2024 protokoll nr.61 “Per ngritjen e komisionit mbi ndarjen e asetëve të Agjencisë së Shërbimeve Publike.

Gjatë vitit 2024 u bë ndarja e aktiveve ndërmjet ASHPU dhe ASHPR me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.100 dt.39,09,2024 nr.prot 4375/1 dt.03,10,2024 ‘’Për një ndryshim në VKB nr.7 datë 26,01,2024 Për miratimin e ndarjes së asetëve të Agjencisë së Shërbimeve Publike’’ ndërmjet ASHPR dhe ASHPU

Gjatë vitit 2024 të dy institucionet gjatë veprimtarisë së tyre kanë vepruar të ndarë ndërmjet njëri-tjetrit dhe me aktivet sipas pronësisë së tyre të cilat ca u trashëguan nga ndarja dhe ca u blenë si asetë të reja.

Gjatë veprimtarisë së tyre u vu re që ASHPR kishte nevojë më tepër për mjetin Autovinç NISAN me targa AA624 PM transferuar ASHPU sipas VKB nr.100 të përmendur më lart, për arsye se automjet është më i përshtatshëm për përdorim në terene urbane gjë të cilën e mbulon ASHPU si fushë të veprimtarisë.

Për sa më sipër siç është biseduar paraprakisht ndërmjet dy titullarve kërkojmë nga ana juaj të na miratoni transferimin e automjetit “Autovinç NISAN me targa AA624 PM” dhe ne do ju transferojmë automjetin “Autoveture e Re Elektrik VW ID4 LFVVB9E66P5006604 me targa AB645PX”

Të dhënat kontabile të automjetit që do të transferohet nga ASHPR në ASHPU janë si më poshtë:

| Nr | Pershkrimi  | Njesia | Sasia | Cmimi     | Vlera     | Viti vënies në punë | Amortizimi Akumuluar | Vlera me 31.12.2024 |
|----|---|--------|-------|-----------|-----------|---------------------|----------------------|---------------------|
| 1  | Autoveture e Re Elektrik VW ID4 LFVVB9E66P5006604 AB645PX | copë   | 1     | 3,000,000 | 3,000,000 | 18.9.2024           | 250,000              | 2,750,000           |

Duke ju falenderuar për mirkuptimin

Konc.P.Sektori mekanikës Gazmend Gaxhja  
Kocp.P.finc.Burbuqe Dedja

Pranoi:Drejtori Altin CENOLLI

Miratoi  
KRYETARI  
Gledian LLATJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË

PROJEKT VENDIM

Nr. \_\_\_ Datë \_\_\_ / \_\_\_ /2025  
"Për

Miratimin e transferimit të automjetit "Autoveture e Re Elektrik VW ID4  
LFVVB9E66P5006604 me targa AB645PX nga ASHPR në ASHPU.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54, të ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Këshilli i Bashkisë Elbasan, pasi mori në shqyrtim Relacionin e paraqitur nga Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale Elbasan, Nr. Prot. Datë \_\_\_\_\_ në mbledhjen e tij të datës \_\_\_ / \_\_\_ / \_\_\_

VENDOSI:

1-Të miratojë transferimin e automjetit "Autoveture e Re Elektrik VW ID4 LFVVB9E66P5006604 me targa AB645PX ,nga Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale në Agjencinë e Shërbimeve Publike Urbane sipas përcaktimeve:

| Nr | Pershkrimi  | Njesia | Sasia | Cmimi     | Vlera     | Viti vënies në punë | Amortizimi Akumuluar | Vlera me 31.12.2024 |
|----|---|--------|-------|-----------|-----------|---------------------|----------------------|---------------------|
| 1  | Autoveture e Re Elektrik VW ID4 LFVVB9E66P5006604 AB645PX | copë   | 1     | 3,000,000 | 3,000,000 | 18.9.2024           | 250,000              | 2,750,000           |

2. Agjencia e Shërbimeve Publike Urbane Elbasan, në zbatim të udhëzimit nr.30 dt.27.11.2011 pika 108: Të dërgojë një Konfirmimi zyrtar ,që vërteton përfundimin e transaksionit,Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale .

3. Ngarkohen Drejtorët e Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale dhe Urbane Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.

5-Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

Konc.P.Sektori mekanikës Gazmend Gaxhja

Koep.P.finc.Burbuqe Dedja

Pranoi:Drejtori Altin CENOLLI

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN

Nr. 1590 prot.

Elbasan më 26 .03. 2025

RELACION

**“VLERËSIMET DHE PARASHIKIMET AFATMESME TË TË ARDHURAVE PËR  
VITET 2026-2028**

**Drejtuar : Këshillit Bashkiak Elbasan**

**Të nderuar Këshilltarë !**

Në projekt buxhetin afatmesëm 2026-2028, parashikimi i të ardhurave për Bashkinë Elbasan është mbështetur kryesisht në llogaritjet e kapacitetit të taksave e tarifave, informacion i përfituar nga programi i taksave vendore, bazuar në ecurinë e realizimit të tyre në vite si dhe politikat e përcaktuara për periudhën në vijim, duke u mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore për to, si dhe paketën fiskale të Bashkisë Elbasan për vitin 2025, miratuar me VKB nr.139, datë 26.12.2024.

Si rrjedhim i këtyre politikave, të ardhurat e Bashkisë Elbasan për vitin 2026, paraqiten me një rritje prej 3% në krahasim me vitin 2025, ndërsa në vitet 2027 dhe 2028 propozohet të kenë rritje përkatësisht me 2% më shumë se viti respektiv i mëparshëm. Përjashtim bëjnë: *taksa mbi truallin, tatimi mbi të ardhurat personale, tarifa e shërbimit për rrjetin kabllor dhe gjobat e biznesit*, të cilat janë rritur me 10 % për vitin 2026, krahasuar me vitin 2025, si dhe *taksa e infrastrukturës*, e cila në tre vitet e ardhshme 2026-2028 është në të njëjtin nivel me planin e vitit 2025. Po kështu, edhe të ardhurat nga *qera objekti*, për vitin 2026 janë planifikuar në të njëjtin nivel me planin e vitit 2025.

Këto parashikime mbështeten në llogaritjet e përgjithshme të cilat janë të lidhura ngushtë me masat që pritet të ndërmerren nga administrata tatimore në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Bashkisë, por dhe jashtë saj, për realizimin e parashikimeve të pretenduara të të ardhurave.

Parashikimi i të ardhurave për këtë periudhë afatmesme parashikon rritjen e nivelit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore duke forcuar kapacitetet administruese dhe duke rritur numrin e taksapaguesve;

Në këtë parashikim janë marrë në konsideratë:

- Rritja e të ardhurave nëpërmjet rritjes së bazës së taksapaguesve dhe luftës kundër evazionit fiskal (evidentimi i subjekteve mospaguese dhe atyre të reja);
- Lehtësimi i procedurave në marrëdhënie me subjektet;
- Ecuria e realizimit të të ardhurave dhe analiza një për një e çdo takse dhe tarife, si dhe faktorët që kanë ndikuar në rritjen ose pakësimin e arkëtimeve.

Struktura e të ardhurave për periudhën 2026 - 2028 :

Në mijë lekë

| <b>Të ardhurat</b>        | <b>Viti 2026</b> | <b>Viti 2027</b> | <b>Viti 2028</b> |
|---------------------------|------------------|------------------|------------------|
| Tatimore                  | 797,429          | 813,375          | 829,642          |
| Jo tatimore               | 944,359          | 963,078          | 982,168          |
| Transferta e pakushtëzuar | 1,195,774        | 1,251,810        | 1,308,539        |
| Transferta specifike      | 655,800          | 655,800          | 655,800          |
| Të ardhura jasht limitit  | 31,554           | 32,185           | 32,828           |
| <b>Totali :</b>           | <b>3,624,916</b> | <b>3,716,248</b> | <b>3,808,977</b> |

Burimet e financimit të buxhetit për Bashkinë Elbasan, përbëhen nga:

| 9. Fondi Rezervë dhe Kontigjenca         | 30,000           | 31,500           | 33,000           |
| <b>Totali Programeve :</b>               | <b>3,624,916</b> | <b>3,716,248</b> | <b>3,808,977</b> |

Në këtë material nuk janë përfshirë shpenzimet nga transfertat e kushtëzuar, si : ndihmat ekonomike, gjendjet civile, bursat e nxënësve, etj. të cilat janë funksione të deleguara dhe financohen nga buxheti i shtetit, pasi nuk janë objekt i vendimmarrjes.

Ky dokument, hartimi i Tavanëve Përgatitore të Shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, për Bashkinë Elbasan, është hartuar nga administrata e Bashkisë, GMS, sipas

metodologjisë së re, në kuadër të projektit të Qeverisë Zvicerane, ku këtë vit bëjnë pjesë tetëmbëdhjetë bashki pilot, me asistencë të Ministrisë së Financave.

Programi Buxhetor Afatmesëm është instrumenti më i rëndësishëm i menaxhimit financiar, i cili synon integrimin e programit të Bashkisë Elbasan me nevojat e qytetarëve dhe që do të shërbejë si bazë për planifikimin e shpenzimeve korente dhe kapitale për periudhën 2026 -2028, duke prezantuar politikat financiare afatmesme të Bashkisë.

Gjithashtu, ky program u shërben drejtuesve të programeve dhe të gjitha njësive shpenzuese pasi përcakton në menyrë të qartë politikat për çdo program dhe u jep mundësi të përcaktojnë kostot dhe prioritetet e tyre për çdo aktivitet, brenda kontekstit të mundësive të disponueshme financiare.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KRYETARI**

**Gledian Llatja**





REPUBLIKA E SHQIPERISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Datë \_\_\_\_ .03. 2025

P/VENDIM

NR. \_\_\_\_\_, DATË \_\_\_\_\_ . \_\_\_\_\_ . 2025

MBI

“TAVANET PËRGATITORE TË SHPENZIMEVE, TË PROGRAMIT BUXHETOR  
AFATMESËM 2026-2028”

Këshilli Bashkiak i Qytetit Elbasan i mbledhur sot më datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2025, pasi mori në shqyrtim materialet e përgatitura nga Bashkia e Qytetit Elbasan, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, “Mbi tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028”, mbështetur në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësisve të vetëqeverisjes vendore”, si dhe Udhëzimin nr.8, datë 28.02.2025 të Ministrisë së Financave “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028”,

VENDOSI :

1. Miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve, të programit buxhetor afatmesëm për tre vitet e ardhshme 2026-2028, sipas materialit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi për Menaxhimin Strategjik.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETAR  
Sokol Sinani

KRYETAR  
Lutfi Lala

Dr.Buxhet Fin.: A.Merkja

D.P.Sh.M: S. Mehmeti

D.P.Zh.T.P.P: D.Meta

D.P.K.S.A.R.S: D.Rroseni

D.P.M.C.M.B.P: Sh. Çullhaji

Dr.Juridike: A.Hoxha

Zv/kryetar : A. Shehu

Zv/kryetar : A. Sula



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA ELBASAN**  
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE RURALE  
DREJTORIA E PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr. 1285 Prot.

Elbasan, më 26 . 03 . 2025

**RELACION**

**PËR TRANSFERIMIN E 2(dy) AUTOMJETEVE TIP FORISTRADË**

***Të nderuar Këshilltar!***

Në bazë të ristrukturimit të Bashkisë Elbasan Agjencia e Pyjeve Bujqësisë dhe Mjedisit si agjenci Vartëse tjetërsohet në Agjencinë e mbikqyrjes dhe kontrollit sipas vendimi të Këshillit Bashkiak nr 141 datë 26.12.2024 "Miratimin e riorganizimit të Njesive operative vartëse të Bashkisë dhe numrit maksimal të punonjësve të tyre dhe të aparatit të administratës të Bashkisë Elbasan për vitin 2025" nga kjo struktura Drejtoria e Pyjeve dhe Bujqësi ka kaluar pranë Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale nga kjo lind nevoja e Transferimit të Automjeteve që përdoren nga kjo strukturë prandaj bazuar në :

1. Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54;
2. Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"
3. Udhëzimit të ministrit të Financave Nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitet e sektorit publik",
4. Në bazë të Vendimit Nr. 778 Dt. 15.12.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 153 Dt. 07.04.2009 Për miratimin e rregullores për zbatimin e kodit rrugor të RSH" të ndryshuar, neni 22 pika 5, nga procedura e prokurimit datë 25/06/2024 "Blerje Automjetet Foristradë për Agjencinë e pyjeve të cilët si dhe në bazë të kontratës nr 358/9 prot datë 22/07/2024.
5. Bazë të VKB nr 114 datë 23/10/2024 "Për miratimin e normave dhe kriterëve për disiplinimin e shpenzimeve për automjete motorrike në administrim të APMV"

***Kërkesj më:***

Këshillit Bashkiak Elbasan të bëjë Transferimin e dy automjeteve si më poshtë për përdorim të Drejtorisë së Pyjeve dhe Bujqësisë pranë Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale.

- Automjet të përdorur tip Volvo XC60 YV1DZ694692012844 Targa AB 648 PT
- Automjetit të përdorur tip Nissan Pathfinder VSKJAWR51U0414609 Targa AB 589 RA

Konceptoi: Xh. Muca

D. Topuzi

Miratoi: K. Gripshi

Konfirmoi: Arben Hoxha

Nën/ KRYETARI

Asim Sula





REPUBLIKA E SHQIPËRIË

**BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK**

**PROJEKT-VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ 2025

**PËR TRANSFERIMIN E 2(dy) AUTOMJETEVE TIP FORISTRADË**

Bazuar në:


1. Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54;
2. Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"
3. Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik",
4. Në bazë të Vendimit Nr. 778 Dt. 15.12.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 153 Dt. 07.04.2000 "Për miratimin e rregullores për zbatimin e kodit rrugor të RSH" të ndryshuar, neni 22 pika 5, nga procedura e prokurimit datë 25/06/2024 "Blerje Automjetet Foristradë për Agjencinë e pyjeve të cilët si dhe në bazë të kontratës nr 358/9 prot datë 22/07/2024.

**KËSHILLI BASHKIAK  
V E N D O S I**


1. Transferimin e dy automjete tip fouristradë nga Agjencia e Pyjeve Bujqësisë dhe Mjedisit tek Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale me të dhënat si me poshtë:
  - Automjet të përdorur tip Volvo XC60 YVIDZ694692012844 Targa AB 648 PT
  - Automjetit të përdorur tip Nissan Pathfinder VSKJAWR51U0414609 Targa AB 589 RA
2. Normativa e Harxhimit do të jetë sipas VKB nr 114 datë 23/10/2024 "Për miratimin e normave dhe kriterëve për disiplinimin e shpenzimeve për automjete motorrike në administrim të APMV"
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

**KRYETAR**

**Lutfi Lala**

Konceptoi: Xh.Muca 

D. Topuzi 

Miratoi: K.Gripshi 

Konfirmoi: Arben Hoxha 



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN

RELACION

Nr. 1297 datë 26.3.2025

Për miratimin e normave dhe kritereve për disiplinimin e shpenzimeve për Automjete motorrike në administrim të ASHPU”

Bazuar në:

1. Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,neni 54
2. Ligjin nr.10296,datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”
3. Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

Sipas kontrates Nr. 355/7 Prot,Dt. 24.09.2024 është blerë një mjete i ri, autovinc tip Jmc me targë AB 721 SN,nr.shasie LEFYEDC26RHN22494 e cila është në administrim të Agjencisë së Shërbimeve Publike Urbane Elbasan.

**Normativat e konsumit të karburantit është 12 Litra/ore per autovincin .**

Bashkengjitur relacionit është procesverbali përkatës.

Agjencia e Shërbimeve Publike Urbane Elbasan ka të drejtën dhe përgjegjësinë për të marrë të gjitha masat për kontrollin dhe evidentimin e të gjitha lëvizjeve dhe orëve të punës të automjetit, me qëllim mirëmenaxhimin e konsumit të karburantit, duke zbatuar dispozitat ligjore në fuqi.

Agjencia e Shërbimeve Publike Urbane Elbasan ka të drejtën dhe përgjegjësinë për përballimin me fonde te buxhetit vendor të njësisë shpenzuese , të gjitha shpenzimeve per karburant ,pjesë këmbimi dhe të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera ligjore (kolaudim,siguracion,etj)për përdorimin normal të mjeteve motorrike ,duke zbatuar dispozitat ligjore në fuqi.

Konceptoi: S.Finance Blerina Kotorri

P/Sek Teknik dhe mekanik Erind Osmani

Pranoi: Dr. Pergj Agron Lulaj

Në mungesë dhe me porosi  
ZV/Kryetari

Asim SULA



Miratoi

KRYETARI

**Gledian LLATJA**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA ELBASAN**  
**AGJENCIA SHERBIMEVE PUBLIKE URBANE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Dt. \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2025

**PROJEKT VENDIM**

Për miratimin e normave dhe kriterëve për disiplinimin e shpenzimeve për Automjete për përdorim të vecantë në administrim të ASHPU”

Bazuar në:

1. Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,neni 54
2. Ligjin nr.10296,datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”
3. Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

**VENDOSI:**

- 1.Të miratojë normativat e konsumit të karburantit për mjetet e ri (autovinc JMC me targe AB721SN) në administrim të Agjencisë së Shërbimeve Publike Urbane Elbasan
- 2.Ngarkohet Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve Publike Urbane Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

Konceptoi:S.Finance Blerina Kotorri

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**  
**Sokol Sinani**

**Kryetari i Keshillit Bashkiak**  
**Lutfi Lala**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
AGJENCIA SHERBIMEVE PUBLIKE URBANE

Nr. 11/2 Prot

Dt. 21.03.2025

PROCES VERBAL

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore; në Ligjin Nr 10296,datë 08.07.2010'Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"për nevojat e përdorimit racional dhe të përditshëm të karburantit

Mbahet ky procesverbal në prani të komisionit të ngritur me urdhërin Nr 11/1 datë 20.03.2025

Anetarët e komisionit:

- Kristo Muça
- Ramiz Pisha
- Graciano Dunja

Në bazë të verifikimit të fakteve dhe provave konkludohet si më poshtë :

- Mjeti tip **Autovinc JMC** me targë **AB 721 SN** harxhon **12 litra/ore pune** Gazoil D1

Në përcaktimin e normativave u mbajten parasysh normativat egzistuese,disa tregues të rëndësishëm sic jane viti i prodhimit ,tipi e lloji i mjetit,amortizimi i tij,gjendja reale teknike e mjetit,rrugët që do te përshkohen,ndalesa në semafore,trafikun ne qytet,natyra e punës për makinerinë e rënde,nevojat e përdorimit të funksioneve shtesë etj.

Këto normativa do të zbatohen për periudhën **01.01.2025-31.12.2025**

**KOMISION**

Kristi Muça

Ramiz Pisha

Graciano Dunja

**DREJTOR I PERGJITHSHEM**

Agron Lulaj



## LISTA MAKINERIVE

## ADMINISTRATA

| Nr | Targa e mjetit | Tipi I mjetit | Norma e konsumit                     | KARBURANTI |
|----|----------------|---------------|--------------------------------------|------------|
| 1  | AB 576 DF      | Volkswagen    | 9 Litra/100 km<br>Ne muaj 400Litra   | Gazoil D 1 |
| 2  | AA 101 DC      | Volkswagen    | 9 Litra/100 km<br>Ne muaj 250 litra  | Gazoil D 1 |
| 4  | AA 256 EG      | Benz Mercedes | 12 Litra/100 km<br>Ne muaj 250 litra | Gazoil D 1 |

## AGJENCIA E SHERBIMEVE PUBLIKE URBANE

|   | Targa e mjetit | Tipi imjetit            | Norma e konsumit      | Karburanti |
|---|----------------|-------------------------|-----------------------|------------|
|   |                | AUTOVINCAT              |                       |            |
| 1 | AA 624 PM      | Nissan autovinc         | 10 litra / 1 ore pune | Gazoil D 1 |
|   |                | FADROMAT                |                       |            |
| 2 | AB197NP        | FadromeFermec           | 8 litra / 1 ore pune  | Gazoil D 1 |
|   |                | KAMIONCINAT             |                       |            |
| 3 | AB102NP        | Kamioncine Benz 3.7 Ton | 17 litra / 100 km     | Gazoil D 1 |
| 4 | AB 864 CK      | Kamioncin ford tranzit  | 12 litra /100 km      | Gazoil D 1 |
|   |                | FORISTRADAT             |                       |            |
| 5 | TR 3690 S      | Mitsubishi L 200        | 12 litra / 100 km     | Gazoil D 1 |
|   |                | FURGONAT                |                       |            |
| 6 | AA 126 OB      | Ford-Tranzit            | 10Litra/100 km        | Gazoil D 1 |
| 7 |                | Minieskavator ET-16     | 3.5 litra/ore         | GAZOIL D1  |
|   |                | KAMIONAT                |                       |            |

|   |           |             |                  |            |
|---|-----------|-------------|------------------|------------|
| 8 | AB 156 BE | Kamion benz | 45 litra /100 km | Gazoil D 1 |
|---|-----------|-------------|------------------|------------|

| Nr | TARGA | Mjete motorike                    | Norma e konsumit | Karburanti |
|----|-------|-----------------------------------|------------------|------------|
| 9  |       | Gjenerator 10 kw                  | 0.7 l/ore        | Gazoil D 1 |
| 10 |       | Betoniere                         | 1 Lit /1 m3      | Benzine    |
| 11 |       | Motorseke                         | 0.6 l/ore        | Benzine    |
| 12 |       | Korse Bari                        | 0.5 l/100 m2     | Benzine    |
| 13 |       | Motorrsharre Bordurash            | 0.6 l/ ore pune  | Benzine    |
| 14 |       | Freze                             | 3.5L/1ore pune   | Benzine    |
| 15 |       | Motorrkorse me rrota              | 0.6l/100m2       | Benzine    |
| 16 |       | Motorrsaldatrice IANCIU           | 1.5l/ 1 ore pune | Benzine    |
| 17 |       | Makine krasitje me fije           | 0.5 Litra/ore    | Gazoil D1  |
| 18 |       | Betoniere me benzine              | 1.5 Litra/ore    | Benzine    |
| 19 |       | Vidator ngjeshes trotuar me nafte | 1 Liter/ore      | Gazoil D1  |
| 20 |       | Goditese per aspsfalt dhe pllaka  | 1 Liter/ore      | Benzine    |
| 21 |       | Makine prerese asfalti me benzine | 1.2 Litra/ore    | Benzine    |
| 22 |       | Makineri grirese degesh           | 1.8 Litra/ore    | Benzine    |
| 23 |       | Motosharre                        | 0.6 Litra/ore    | Benzine    |
|    |       |                                   |                  |            |

## MJETE TE REJA AGJENCIA SHERBIMEVE PUBLIKE URBANE

| Nr       | Autovinc                      | Targa          | Norma e konsumit    | Karburanti       |
|----------|-------------------------------|----------------|---------------------|------------------|
| <u>1</u> | <u>Autovinc</u><br><u>JMC</u> | <u>AB721SN</u> | <u>12 Litra/Ore</u> | <u>Gazoil D1</u> |

Konceptoi:

Spec/Finance Blerina Kotorri

Magaznier nafte/rekupro:

Graciano Dunja

Miratoi

Drejtori I Pergjithshem

Agron Lulaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE URBANE

NI-1538-9101

DT. 26.13/2025

**Lënda:**Relacion Për transferimin e automjetit “Autovinc Nissan me targë AA624PM ,nga Agjencia e Shërbimeve Publike Urbane në Agjencinë e Shërbimeve Publike Rurale.

**KËSHILLIT BASHKIAK**

**BASHKIA ELBASAN**

Në zbatim të neneve 8, 9, 64 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Ligjit 10296 dt.08,07,2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar,

VKB nr.82 dt.13.09.2023 “ Për krijimin e Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale dhe atë të Shërbimeve Urbane” si dhe Urdhërit Administrativ të Kryetarit të Bashkisë nr. 8 dt.09,01,2024 protokoll nr.61 “Per ngritjen e komisionit mbi ndarjen e aseteve të Agjencisë së Shërbimeve Publike.

Gjatë vitit 2024 u bë ndarja e aktiveve ndërmjet ASHPU dhe ASHPR me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.100 dt.39,09,2024 nr.prot 4375/1 dt.03,10,2024 ‘Për një ndryshim në VKB nr.7 datë 26,01,2024 Për miratimin e ndarjes së aseteve të Agjencisë së Shërbimeve Publike” ndërmjet ASHPR dhe ASHPU

Gjatë vitit 2024 të dy institucionet gjatë veprimtarisë së tyre kanë vepruar të ndarë ndërmjet njëri-tjetrit dhe me aktivet sipas pronësisë së tyre të cilat ca u trashëguan nga ndarja dhe ca u blenë si asete të reja.

Gjatë veprimtarisë së tyre u vu re që ASHPR kishte nevojë më tepër për mjetin Autovinç NISAN me targa AA624 PM transferuar ASHPU sipas VKB nr.100 të përmendur më lart, për arsye se ky mjet i përshtatet me shumë veprimtarisë në zona rurale të cilën e mbulon ASHPR..Gjatë vitit

2024 ASHPR ka blerë me fondet e akorduara nga Bashkia automjetin “Autoveture e Re Elektrik VW ID4 LFVVB9E66P5006604 me targa AB645PX “.Ky automjet është më i përshtatshëm për përdorim në terrene urbane gjë të cilën e e mbulon ASHPU si fushë të veprimtarisë.

Për sa më sipër siç është biseduar paraprakisht ndërmjet dy titullarve kërkojmë nga ana juaj të na miratoni transferimin automjetin “Autoveture e Re Elektrik VW ID4 LFVVB9E66P5006604 me targa AB645PX” dhe ne do ju transferojmë automjetin “Autovinç NISAN me targa AA624 PM”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Konc.P.Sektori teknik dhe mekanik Erind Osmani  
Kocp.spec.finc.Blerina Kotorri

Pranoi:Drejtori Agron LULAJ

Në mungesë dhe me porosi

ZV/Kryetari

Asim SULA



Miratoi

KRYETARI

Gledian LLATJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË

PROJEKT VENDIM

Nr. \_\_\_\_ Datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/2025  
“Për

Miratimin e transferimit të automjetit “Autovinc Nisan me targe AA624PM nga  
ASHPU në ASHPR.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54, të ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Këshilli i Bashkisë Elbasan, pasi mori në shqyrtim Relacionin e paraqitur nga Agjencia e Shërbimeve Publike Urbane Elbasan, Nr. Prot. Datë \_\_\_\_ në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

VENDOSI:

1-Të miratojë transferimin e automjetit “Autovinc Nisan me targe AA624PM, nga Agjencia e Shërbimeve Publike Urbane në Agjencinë e Shërbimeve Publike Rurale sipas përcaktimeve:

| Nr | Pershkrimi                      | Njesia | Sasia | Cmimi     | Vlera     | Viti vënies në punë | Amortizimi Akumuluar | Vlera me 31.12.2024 |
|----|---------------------------------|--------|-------|-----------|-----------|---------------------|----------------------|---------------------|
| 1  | Autovinc Nisan me targe AA624PM | copë   | 1     | 2,640,000 | 2,640,000 | 2017                | 2,198,812            | 441,188             |

2. Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale Elbasan, në zbatim të udhëzimit nr.30 dt.27.11.2011 pika 108: Të dërgojë një Konfirmimi zyrtar ,që vërteton përfundimin e transaksionit,Agjencisë së Shërbimeve Publike Urbane .

3. Ngarkohen Drejtorët e Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale dhe Urbane Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.

5-Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

Konc.P.Sektori teknik dhe mekanik Erind Osmani 

Kocp.spec.finc.Blerina Kotorri 

Pranoi:Drejtori Agron LULAJ 



**Sekretari i Këshillit Bashkiak**

**Sokol Sinani**

**Kryetari i Këshillit Bashkiak**

**Lutfi Lala**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KESHILLI I BASHKISË ELBASAN

Nr. 1663 prot

datë 28/03/2025

**Raport mbi Veprimtarinë e Keshillit Bashkiak për Vitin 2024 dhe Transparençën në  
Procesin e Vendimrjes.**

Keshilli Bashkiak, si organi përfaqësues dhe vendimtar i qeverisë bashkiake, i ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse duke respektuar parimet e demokracisë vendore, Kartës Europiane të Autonomisë Vendore, transparencës qeverisëse, ligjshmerisë, si dhe duke përdorur me efektivitet dhe efikasitet burimet njerëzore, financiare, fizike e natyrore, duke punuar bazuar në parimet e interesit publik, integritetit, objektivitetit, përgjegjshmerisë, transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit.

**Pjesëmarrja keshilltare në aktivitete**

a. Mbledhje plenare

b. Mbledhje në komisione

c. Konsultime

d. Trajnime

e. Aktivitete të tjera

**Vendimarrja e Keshillit**

Keshilli i Bashkisë Elbasan, gjatë vitit 2024 ka patur si qëllim miratimin e vendimeve që i përkasin shërbimit ndaj qytetarëve, zhvillimit të qytetit, mbështetjes dhe promovimit të sektoreve të ndryshme të ekonomisë (bujqësisë, industrisë, shërbimeve, tregtisë, turizmit, etj) me ndihmë ekonomike dhe vendimet me karakter ekonomik që kanë të bëjnë me:

1. Zbatimin e buxhetit për vitin 2024, projektet e propozuara nga ekzekutivi për përmirësimin e shërbimeve dhe investimet; dhe
2. Ka marrë vendim çdo muaj për dënie ndihme financiare, për familje, jo vetëm nga fondi i kushtëzuar, por edhe nga të ardhurat e Bashkisë Elbasan si më poshtë:



| Nr. | Muaji   | Ndihme ekonomike per familje nga te ardhurat e Bashkise | Ndihme ekonomike per familje nga Fondi i kushtezuar 6 % |
|-----|---------|---|---|
| 1   | Janar   | 1   | 1   |
| 2   | Shkurt  | 1   | 1   |
| 3   | Mars    | 1   | 1   |
| 4   | Prill   | 1   | 1   |
| 5   | Maj     | 1   | 1   |
| 6   | Qershor | 1   | 1   |
| 7   | Korrik  | 1   | 1   |
| 8   | Gusht   | 1   | 1   |
| 9   | Shtator | 1   | 1   |
| 10  | Tetor   | 1   | 1   |
| 11  | Nentor  | 1   | 1   |
| 12  | Dhjetor | 1   | 1   |

#### Te tjera vendime te miratuara:

- Dhenie me qera te tokave bujqesore, lista e siperfaqeve kullosore dimerore dhe verore, me qellim miremenaxhimin e tyre dhe perdorimin e ketyre tokave ne dobi te fermereve dhe zhvillimit te bujqesise;
- Shtesa dhe ndryshime te buxhetit per vitin 2024 me qellim rritjen e efikasitetit te burimeve financiare dhe perdorimin e tyre ne sherbim te komunitetit, zhvillimit urban dhe rural, thithjes se investimeve dhe mbeshtetjes se ekzekutivit ne projektet e fituara nga qeveria qendrore, me fonde te Bashkimit European (BE), dhe donatore te trere te huaj;
- Buxhetin e vitit 2024 dhe projekt-buxhetin afatmesem te Bashkise Elbasan per vitet 2024-2026;
- Per sistemin e taksave dhe tarifave vendore ne bashkine Elbasan per vitin 2024;
- Dhenie te titujve "Qytetar Nderi bazuar ne kerkesat dhe trajtimin e dy komisioneve;
- Bursat per nxenesit e arsimit para-universitar dhe konviktet e shkollave te mesme profesionale, per vitin shkollor 2023-2024, si dhe mbeshtetjen e nxenesve ekselente.

#### Struktura e vendime te miratuara nga Keshilli viti 2024

- Nga totali 143 vendime te marra 143 vendime kane kerkuar konfirmimin e Prefektit te Qarkut nga te cilet 143 vendime jane konfirmuar dhe 0 jane kthyer, te cilet pas plotesimeve te kerkuara nga instucioni i Prefektit te Qarkut jane kaluar ne mbledhjet e radhes;
- Vendimet me karakter normativ kane pasur te bejne me buxhetin dhe zbatimin e tij, permiresimin e sherbimeve, detajimin e shpemdardjes se buxhetit etj;
- Dhenie te tokave me qera, mbeshtetjen e projekteve te fituara nga ekzekutivi, planet vendore per pastrimin, mbrojtjen nga zjarri, planet sociale te bashkise si dhe vendimet per mbeshtetjen e familjeve qe kane patur demtime te banesave te tyre nga zjarri;

- Vendimet te cilat jane me karakter personal, 24 prej tyre kane te bejne me dhenien e ndihmes ekonomike sipas muajve, vendime per procesin e privatizimit te banesave per lidhjen e kontratave para noterit, per banesat e para viteve 90, vendime per miratimin e listes se perfituesve te subvencionit te qirase dhe subvencionit te kredise, vendime per shtyrjen e afatit te kredise si dhe per vendosjen ne Shtepine e te Moshuarve si dhe titujt e nderit;
- 6 vendime me karakter jo normativ jane vendime qe kane te bejne me procedurat e zhvilluara qe lidhen me raste specifike dhe nuk kanë efekt të përgjithshëm ndaj të tjerëve.
- Dhene 2 tituj "Qytetar Nderi ".

Keto vendime te Keshillit, tregojne bashkepunimin e Keshillit me administraten e Bashkise per tju pergjigjur ne kohe dhe sipas legjislacionit ne fuqi gjithe shqetesimeve dhe problematikave te komunitetit te qytetit te Elbasanit dhe njesive administrative.

Keshilli gjate kesaj periudhe ka qene aktiv, duke mbajtur mbledhje te radhes, mbledhje jashte radhe, sipas tabelës se meposhteme:

| Muaji   | Nr total i Mbledhjeve | Mbledhje te radhes | Mbledhje jashte radhe |
|---------|-----------------------|--------------------|-----------------------|
| Janar   | 1                     | 1                  | -                     |
| Shkurt  | 1                     | 1                  | -                     |
| Mars    | 1                     | 1                  | -                     |
| Prill   | 1                     | 1                  | -                     |
| Maj     | 1                     | 1                  | -                     |
| Qershor | 1                     | 1                  | -                     |
| Korrik  | 3                     | 1                  | 1                     |
| Gusht   | 1                     | 1                  | -                     |
| Shtator | 1                     | 1                  | -                     |
| Tetor   | 1                     | 1                  | -                     |
| Nentor  | 2                     | 1                  | 1                     |
| Dhjetor | 1                     | 1                  | -                     |

Gjate vitit 2024 jane zhvilluar online 1 prej mbledhjeve jashte radhe me qellim arritjen e afateve.

Pjesemanja e keshilltareve ka qene aktive si ne mbledhjet e komisioneve ashtu dhe ne procesin e vendimmanjes ne mbledhjet plenare online apo ato fizike. Komisionet e perhershme te Keshillit jane mbledhur per te diskutuar dhe miratuar projekt vendime te sjella nga administrata e Bashkise Elbasan qe kane te bejne sidomos me vendimet me karakter ekonomik dhe ne dhenien e pronave me qera, titujt e nderit, çeshtje juridike etj

Ne vitin 2024 jane zhvilluar 37 mbledhje te Komisioneve.

| Nr | Muaji  | Mbledhje te Komisione te Perhershme |
|----|--------|-------------------------------------|
| 1  | Janar  | 4                                   |
| 2  | Shkurt | 3                                   |

|       |         |    |
|-------|---------|----|
| 3     | Mars    | 3  |
| 4     | Prill   | 4  |
| 5     | Maj     | 1  |
| 6     | Qershor | 3  |
| 7     | Korrik  | 1  |
| 8     | Gusht   | -  |
| 9     | Shtator | 5  |
| 10    | Tetor   | 4  |
| 11    | Nentor  | 4  |
| 12    | Dhjetor | 5  |
| Total |         | 37 |

Duke u nisur nga karakteri i vendimeve, ato ndahen ne vendime per çeshtje:

1. Financiare;
2. Sociale
3. Infrastrukturen dhe strehimin
4. Problemet urbane dhe asetet
5. Emergjencat civile;
6. Çeshtje te arsimit kultures;
7. Tajtimi i mbetjeve;
8. Planet lokale

### **Tranaparenca e Keshillit.**

Ne zbatim te rregulloreve te miratuara eshte vene ne funksionim regjistri elektronik i ankesave/kerkesave dhe regjistri elektronik i iniciativave/peticioneve ku regjistrohen dhe evidentohen te gjitha ankesat/kerkesat e mberitura ne drejtim te Keshillit te Bashksie, regjistri elektronik i mbledhjeve te Keshillit me te gjitha kolonat qe sigurojne informacion te plote per zhvillimin e mbledhjeve, dhe regjistri elektronik i projektakteve (ne faqen e internetit te bashkise, rubrika Keshilli).

Gjate vitit 2024 u depozituan ne total 0 kerkesa drejtuar Keshillit Bashkiak. Kerkesat jane trajtuar dhe jane koordinuar me ekzekutivin e bashkise dhe ne te gjitha rastet jane informuar qytetaret.

Eshte pasuruar faqja e internetit te Bashkise, Rubrika e Keshillit Bashkiak me informacione per publikun nepermjet kategorive te meposhteme:

- Anetaret e Keshillit Bashkiak;
- Struktura/Komisionet;
- Rregulloret e Keshillit;
- Vendime te Keshillit Bashkiak;
- Vendimet e Kryesise;
- Njoftimet e Mbledhjeve;
- Projektvendimet;

- Procesverbalet;
- Regjistri elektronik i kerkesave, ankesave, peticioneve dhe iniciativave qytetare;
- Regjistri elektronik i mbledhjeve;
- Regjistri elektronik i projektakteve;
- Konsultimet publike;
- Aktivitete te Keshillit, etj

Gjithçka me lart behet transparente, dhe qytetaret mund t'i gjejne ne faqen e internetit te Bashkise, rubrika Keshilli te gjitha informacionet dhe dokumentat perkatese.

Per te thelluar me shume transparencen, Keshilli i paisur dhe mbeshtetur nga Projekti Bashki te Forta me paisje IT te plota (donacion-Ekran, Kamera, Miktofona, Laptop, dhe kablllo), ka regjistruar dhe transmetuar direkt (live) ne facebook te Keshillit gjashte nga dymbedhjet e mbledhje te Keshillit gjate vitit 2024.

### **Roli perfaqesues i Keshillit**

Ne zbatim te ligjit 139/2015 "**Per Veteqeverisjen Vendore**", i ndryshuar si dhe ligjit 146/2014, "**Per konsultimin Publik**", ne zbatim te planit te aktiviteve/punes dhe pergatitjes se Tavanave Buxhetore te Programit Buxhetor Afatmesem (PBA) 2025-2027, paketes Fiskale 2025, dokumentin final te PBA 2025-2027 dhe Buxhetit 2025, Keshilli ne bashkepunim me ekzekutivin kane marre pjese ne 28 degjese publike ne te gjitha njesite administrative te bashkise me grupe te ndryshme interesi, perfshire "**keshillin rinor**", grate grupet vulnerable, etj, qe kane te bejne me hartimin e Paketes Fiskale per vitin 2025, me zbatimin e buxhetit per vitin 2024 dhe kerkesat buxhetore per vitin 2025, persa i perket miratimit te sistemit te taksave dhe tarifave vendore per vitin 2025, te buxhetit te Bashkise Elbasan per vitin 2025 si dhe projekt-buxhetit afatmesem te Bashkise Elbasan per vitet 2025-2027.

Aktivitetet e mesipere u publikuan ne faqen e internetit te Bashkise, Rubrika Keshilli Bashkiak, Aktivitete te Keshillit, dhe ne facebook te Keshillit.

Duke konsideruar rendesine e pjesemarrjes se grupeve vulnerable ne procesin e vendimmarrjes, Keshilli ne zbatim te planit te aktiviteve/punes se tij, me mbeshtetjen e Projektit Bashki te Forta, zhvilloi ne 6 nentor 2024 nje konsultim/degjese te veçante me komunitetin Egjiptian dhe Rom per marrjen e nevojave dhe prioriteteve te ketyre komuniteteve dhe kosiderimin e prioriteteve te tyre ne buxhetin e vitit 2025 dhe ne PBA 2025-2027. Aktiviteti u publikua ne faqen e internetit te Bashkise, Rubrika Keshilli Bashkiak, Aktivitete te Keshillit, dhe ne facebook te Keshillit.

Keshilli ka marre pjese ne seanca degjimore se bashku me administraten e Bashkise ku jane mbajtur shenim kerkesat, sugjerimet dhe opinionet e pjesemarrsesve, i jane percjelle Komisionit te Financave, Buxhetit dhe Aseteve Publike, dhe jane reflektuar/konsideruar ne dokumentat perkatese.

Te gjitha degjesat/konsultimet publike te siperpermendura jane publikuar ne faqen e internetit te Bashkise, Rubrika Keshilli Bashkiak, Aktivitete te Keshillit, dhe ne facebook te Keshillit.

Gjate mbledhjeve te Keshillit Bashkiak, keshtillaret kane shprehur kerkesa dhe ankesa te qytetareve te zonave qe perfaqesojne te cilat i jane parashtruar ekzekutivit dhe jane diskutuar me tej per te marre zgjidhje rast pas rasti.

Duke konsideruar rendesine e ndryshimeve klimatike ne ditet e sotme, Keshilli ne zbatim te planit te aktiviteteve/punes se tij, me mbeshtetjen e Projektit Bashki te Forta, zhvilloi ne 16 shkurt 2024 nje seance te veçante “Mbi ndryshimet klimatike dhe masat e pershtatjes”. Aktiviteti u publikua ne faqen e internetit te Bashkise, Rubrika Keshilli Bashkiak, Aktivitete te Keshillit, dhe ne facebook te Keshillit.

Per vitin 2024 buxheti i Keshillit Bashkiak eshte realizuar pothuajse i plote.

### **Forcimi i kapaciteteve te Keshillit (Komisionet dhe Udheheqja e Keshillit)**

Me mbeshtetjen e Projektit Bashki te Forta, Komisionet e Keshillit Bashkiak – Komisioni i Financave, Buxhetit dhe Aseteve Publike (dy anetare te komisionit), Komisioni i Sherbimeve dhe Strehimit Social, Shendetesise dhe Barazise Gjinore (dy anetare te Komisionit), Komisioni i Arsimit (pese anetare te Komisionit) dhe Komisioni i sherbimeve Publike (dy anetare te Komisionit) u trajnuan intesivisht mbi:

Roli i komisioneve në monitorimin e ekzekutivit;

- Strukturat drejtuese të Këshillit;
- Komisionet e përherëshme të këshillit të bashkisë;
- Objekti i punës së komisioneve;
- Funksionimi i komisioneve;
  - Roli i komisioneve në vendimmarrje, organizimi dhe zhvillimi i mbledhjeve te komisioneve, pergatirja e raporteve te vendimmarrjes se komisioneve per projekt aktet dhe procesverbaleve perkatese;
  - Roli i komisioneve në konsultimin publik të këshillit planifikimi, organizimi dhe zhvillimi i konsultimeve publike sipas planit te konsultimeve te keshillit.

Trajnimet u zhvilluan ne sallen e mbledhjeve te Keshillit te Qarkut Elbasan. Per dy komisionet e para trajnimi u zhvillua ne date 19 prill 2024, dhe per dy komisionet e tjera ne date 16 maj 2024.

Gjithashtu, me mbeshtetjen e Projektit Bashki te Forta, Kryesia e Keshillit – Kryetari dhe dy NenKryetaret e keshillit u trajnuan ne temat si me poshte:

- Vetëqeverisja vendore, rolet dhe funksionimi i Këshillit Bashkiak;
- Roli i këshillit bashkiak në mbikqyrjen e sistemit të kontrollit të brendshëm të bashkisë;
- Drejtuesit e Këshillit Bashkiak, konsultimi publik, planifikimi dhe buxhetimi i këshillit.

Trajnimi u zhvillua ne sallen e mbledhjeve te Keshillit Bashkiak Librazhd, ne date 17 tetor 2024.

## **Barazia gjinore dhe Aleanca e Grave Keshilltare**

Komisioni i Sherbimeve, Strehimit Social, Shendetsise dhe Barazise Gjinore ne bashkepunimme Aleancen e Grave Keshilltare (AGKB) te Bashkise Elbasan, adresuan çeshtje te ndryshme qe sigurojne barazine gjinore ne veprimtarine Bashkise Elbasan dhe se bashku zbatuan aktivitete te nismes - reduktimi i dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Nisma vazhdon zbatimin edhe ne vitin ne vazhdim dhe eshte pjese e buxhetit te Bashkise, viti 2025.

Pas zgjedhjeve rajonale te AGKB te bashkive te tre rajoneve – Elbasan-Berat-Korçe, te zhvilluara ne Berat, ne date 6 mars 2024 te dy drejtueseve te AGKB Elbasan (Kryetarja dhe NenKryetarja, anetare te Bordit Drejtues te Aleances Kombetare te Grave Keshilltare vazhdojne te kontribuojne aktivisht ne udheheqjen e Aleance Kombetare per adresimin sa me te mire te te gjitha çeshtjeve te barazise gjinore ne nivel kombetar dhe vendor.

## **Mbajtja e dokumentacionit**

Me mbeshtetjen e Projektit Bashki te Forta, sekretariati i Keshillit eshte paisur me dosje dhe mbajtja e dokumentacionit eshte si me poshte:

- Dosja e Protokollit te Brendshem (Nderveprimi me Administraten)
- Dosja e korespondences me Prefektin.
- Dosja per Prjekt-Vendimet
- Dosja per Vendimet e Keshillit
- Dosja e Vendimeve dhe Proces Verbalet e mbledhjeve te Kryesise
- Dosjet e Proces Verbaleve te Mbledhjeve te Keshillit (Minutes)
- Dosjet e Proces Verbaleve te Votimit.
- Dosjet e Komisioneve
- Dosjet per Proceset e konsultimeve + Regjistri i Konsultimeve
- Dosjet e Grupeve Politike (nderveprimi te Keshillit me to)
- Dosjet me kerkesat e Keshilltareve per Informim me dok zyrtar
- Dosje per ankesat kerkesat + Regjistri Perkates
- Dosje per Nismat + Regjistri
- Dosje per Planet e punes se keshillit si dhe Buxhetin perkates (nderveprimi me administraten per shoenzimet)
- Dosjet per titujt e nderit dhe komisione te ndryshme qytetare

## **Vazhdimesia dhe e Ardhmja**

Mbetet si detyre mjaft e rendesishme per te ardhmen gjetja e menyrave dhe formave te tjera per te komunikuar me publikun per çeshtje si: diskutimi per buxhetin e bashkise, paketes fiskale, tjetersimit dhe dhenies me qera te pronave, zbatimimi i standardeve e rregulloreve etj. me qellim pjesemarrjen aktive ne vendimmarje te komunitetit, ku çdo keshilltar per aktet normative, te cilat do te diskutohet dhe vendoset ne Keshill, te marre opinionet dhe verejtjet publike ne lagjen ose fshatin qe ata perfaqesojne me qellim qe vendim-marrja te jete ne sherbim te komunitetit.



---

Gjithashtu, mbledhjet e komisioneve duhet te zhvillohen rregullisht, te mbahen procesverbalet dhe pergatiten raportet e vendimarrjes per cdo projekt akt te shqyrtuar dhe prezantuar ne mbledhjet plenare te Keshillit.

Per sa me siper ju falenderojme secilin per kontributin e dhene dhe ju ftojme te jepni mendimet dhe sugjerimet tuaja per permiresimin e punes se Keshillit.

**Sekretar i Këshillit Bashkiak**  
**Sokol Sinani**

**Kryetar i Këshillit Bashkiak**  
**Lutfi LALA**